



Plani Vendor Social

Bashkia Kolonjë

2026-2028



Falenderime

Bashkia Kolonjë shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit Vendor Social 2026-2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë (SHKBSSH) dhe me ekspertizën teknike të “Smart Processes”, të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë Këshillin Bashkiak të Bashkisë Kolonjë, i cili ka mbështetur këtë proces duke siguruar një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse në hartimin e planit.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive e sektorëve vendorë, organizatave të shoqërisë civile, grupeve komunitare dhe partnerëve lokalë që morën pjesë aktivisht në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e nevojave të vërteta të komunitetit.

Tabela e përmbajtjes

Falenderime.....	2
1. Hyrje	6
2. Metodologjia	6
3. Legjislacioni dhe Baza Ligjore	8
3.1 Kuadri kushtetues dhe ligjor	9
3.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar.....	10
3.3 Roli i Bashkisë dhe Strukturave të tyre në ngritjen e Shërbimeve Sociale.....	10
3.4 Kategoritë e shërbimeve sociale	13
3.5 Modalitetet e ofrimit të shërbimeve	17
3.6 Kërkesa ligjore për profesionistët socialë	17
3.7 Prioritetet në zgjerimin e hartës së shërbimeve	18
4. Analiza e të dhënave	19
4.1 Numri i popullsisë sipas gjinisë	19
4.2 Vështrim i përgjithshëm.....	20
5. Individë në Nevojë për Shërbime dhe Shërbimet Egzistuese	21
5.1 Individë që përfitojnë Ndhmë Ekonomike sipas njësive administrative	21
5.2 Individë përfitues sipas gjinisë.....	23
5.3 Individë përfitues sipas grupmoshës	24
5.4 Familjet aplikuese të ndihmës ekonomike.....	24
5.5 Familjet përfituese të ndihmës ekonomike.....	25
5.6 Karakteristikat e familjeve përfituese nga ndihma ekonomike.....	26
5.6.1 Familje me gra kryefamiljare	26
5.6.2 Familje me deri në 2 fëmijë të mitur	26
5.6.3 Familje Rome ose Egjiptiane	27
5.6.4 Familje me të paktën një anëtar me Aftësi të Kufizuara (PAK)	28
5.6.5 Familje me të paktën një pjesëtar në moshë pensioni	29
6. Strehimi Social.....	29
6.1 Numri i familjeve aplikuese për strehim social	29
6.2 Numri i aplikuesve për strehim që janë edhe përfitues të ndihmës ekonomike.....	30
6.3 Godina me infrastrukturë të përshtatshme për shërbime komunitare	30
6.4 Familje përfituese sipas programeve të strehimit	31

7. Punëkërkuesit e papunë në Bashkinë Kolonjë	32
7.1 Punëkërkuesit e papunë sipas njësive administrative	32
7.2 Punëkërkuesit e papunë sipas Gjinisë	32
7.3 Grupet Vulnerabël të Punëkërkuesve të Papunë	33
7.4 Trajnimet Profesionale	34
7.5 Bizneset në territorin e Bashkisë Kolonjë.....	34
8. Personat me Aftësi të Kufizuara	36
8.1 Identifikimi dhe Vlerësimi i Nevojave të Personave me Aftësi të Kufizuara	36
8.2 Karakteristikat e Aftësisë së Kufizuar.....	37
8.3 Shërbimi i strehimit social	38
8.4 Përfituesit nga skema e mbrojtjes sociale – Invalidët e Punës.....	39
8.5 Shërbimi Shëndetësor	39
9. Viktima të dhunës në familje	41
9.1 Dhuna në Familje sipas Njësive Administrative	41
9.2 Mbështetje për Viktimat e Dhunës në Familje.....	42
10. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje	42
10.1 Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.....	42
10.2 Shërbimet për fëmijët në nevojë në Bashkinë Kolonjë.....	43
10.3 Shërbimi i Kujdesit për Fëmijët e Moshës 0–3 vjeç (Çerdhja).....	44
10.4 Shërbimi i Arsimit Parashkollor	44
Frekuentimi në kopshte.....	45
10.5 Shërbimi i arsimit parauniversitar.....	46
Frekuentimi në arsimin fillor	47
Frekuentimi arsimit 9-vjeçar	47
Frekuentimi arsimit i mesëm.....	48
10.6 Shërbimet Psiko-Sociale në Shkollë	49
10.7 Masat lehtësuese të Bashkisë për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje	49
11. Familjet rome dhe egjiptiane	50
11.1 Madhësia e grupit dhe shtrirja në territor	50
11.2 Shërbimet për familjet rome dhe egjiptiane	50
12. Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale	50

12.1 Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale sipas njësive administrative.....	50
12.2 Shërbimet e kujdesit shoqëror për të moshuarit.....	51
13. Personat me varësi nga droga dhe nga alkooli	51
14. Migrantët dhe Emigrantët	52
15. Shërbimet Bazë që ofron Bashkia Kolonjë.....	54
16. Kapacitetet e bashkisë.....	56
17. Vizioni dhe Misioni.....	57
17.1 Vizioni.....	57
17.2 Misioni	57
18. Qëllimet dhe Objektivat.....	57
19. Plani i Veprimit	59
20. Monitorimi dhe raportimi	79
21. Bibliografi.....	81

1. Hyrje

Plani Vendor Social i Bashkisë Kolonjë për periudhën 2026-2028 është një dokument strategjik që udhëheq vendimmarrjen në fushën e shërbimeve sociale në nivel vendor, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe zhvillimit gjithëpërfshirës. Hartimi i këtij plani është zhvilluar në periudhën Maj-Korrik 2025, përmes një procesi konsultativ dhe të bazuar në evidencë, nën koordinimin e Njesisë së Shërbimeve Sociale.

Ky proces u mbështet nga ekspertë të fushës dhe u orientua nga praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare për planifikimin social. Bashkia Kolonjë ka ndërtuar një përvojë të vyer ndër vite në adresimin e nevojave të grupeve vulnerabël, duke konsoliduar shërbime dhe partneritete në nivel vendor dhe rajonal.

Plani synon të analizojë gjendjen ekzistuese të shërbimeve sociale në territor, të identifikojë boshllëqet dhe sfidat, si dhe të përkufizojë objektiva të qarta për periudhën trevjeçare 2026-2028. Dokumenti është hartuar në përputhje me legjislacionin kombëtar, strategjitë përkatëse sektoriale dhe standardet minimale të shërbimeve, duke integruar gjithashtu kontributet e komunitetit dhe aktorëve të shumtë lokalë.

Përmes këtij Plani, Bashkia Kolonjë synon të fuqizojë sistemin komunitar të mbrojtjes dhe kujdesit social, të përmirësojë aksesin, cilësinë dhe gjithëpërfshirjen e shërbimeve, si dhe të rrisë kapacitetet institucionale për të përmbushur me përgjegjësi misionin e saj ndaj qytetarëve më në nevojë.

2. Metodologjia

Procesi i hartimit të Planit Social për Bashkinë Kolonjë është zhvilluar përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, e mbështetur në të dhëna, konsultim me aktorët lokalë dhe orientim drejt standardeve kombëtare. Më poshtë paraqiten hapat e ndjekur:

1. Analiza e kuadrit ligjor dhe strategjik kombëtar

Fillimisht u realizua një shqyrtim i detajuar i dokumenteve ligjore dhe strategjike që udhëheqin planifikimin e politikave sociale në nivel kombëtar. Në fokus ishin:

- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030;
- Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024;
- Strategjia për PAK, barazinë gjinore, të moshuarit dhe grupet vulnerabël,
- Kuadri i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të) në nivel vendor.

Kjo analizë shërbeu për të përcaktuar detyrimet dhe prioritetet që bashkia duhet të adresojë në nivel lokal.

2. Konsultimi me aktorë lokalë dhe ofrues shërbimesh

U zhvilluan takime konsultative me një gamë të gjerë aktorësh, për të siguruar që prioritetet e planit të reflektojnë realisht nevojat dhe perspektivat në terren. Këtu përfshihen:

- Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe stafi teknik i bashkisë,
- Administratorë vendorë dhe përfaqësues të njësive administrative,
- Përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatave që ofrojnë shërbime sociale,
- Partnerë të tjerë ndërinstitutionalë (arsimi, shëndetësia, policia, etj).

3. Analiza e të dhënave sociale dhe administrative

U mbledhën dhe u analizuan të dhëna të detajuara nga burime të ndryshme, përfshirë:

- Sistemi elektronik i shërbimeve sociale,
- Të dhëna administrative nga bashkia dhe njësitë administrative,
- Regjistrat e ndihmës ekonomike, PAK, pensione dhe shërbimeve ekzistuese,
- Statistikat e INSTAT dhe institucioneve kombëtare të monitorimit social.

Kjo analizë ndihmoi në identifikimin e grupeve në nevojë, shportës së shërbimeve ekzistuese, dhe zonave me mungesa të theksuara në mbulim.

4. Vlerësimi i boshllëqeve në raport me standardet kombëtare

Bazuar në standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror të miratuara nga Ministria përkatëse, u krye një vlerësim i kapaciteteve dhe mbulimit aktual në Bashkinë Mat. Ky vlerësim ndihmoi në:

- Identifikimin e boshllëqeve në infrastrukturë dhe burime njerëzore,
- Përcaktimin e shërbimeve të reja të nevojshme,
- Prioritizimin e ndërhyrjeve për periudhën 2026-2028.

5. Hartimi i objektivave dhe Planit të Veprimit

Bazuar në të dhënat, konsultimet dhe boshllëqet e evidentuara, u formulua struktura logjike e Planit Social, përfshirë:

- Objektivat strategjike dhe specifike,
- Masat konkrete të ndërhyrjes,
- Treguesit e monitorimit,
- Aktorët përgjegjës dhe afatet për zbatim.

3. Legjislacioni dhe Baza Ligjore

Shqipëria ka zhvilluar kuadrin ligjor mbi mbrojtjen dhe përfshirjen sociale duke rregulluar kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve, moshuarve, viktimave të dhunës në familje etj. Një rol të vecantë në ngritjen dhe fuqizimin e shërbimeve sociale kanë edhe bashkitë.

Kjo rubrikë synon të paraqesë një përmbledhje të qartë, të strukturuar dhe të zbatueshme të shërbimeve sociale që ofrohen në nivel vendor në Republikën e Shqipërisë. Ai shërben si një udhëzues praktik për bashkitë dhe institucionet e tjera të përfshira në projektimin, ofrimin dhe monitorimin e këtyre shërbimeve, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të përmbushin nevojat e individëve dhe grupeve në nevojë.

Standardet minimale përcaktojnë nivelin themelor të cilësisë, disponueshmërisë dhe aksesueshmërisë që një shërbim social duhet të përmbushë. Ato janë element thelbësor për sigurimin e një ofrimi të barabartë dhe të pandryshueshëm të shërbimeve në të gjitha bashkitë, mbështetjen e punës profesionale të strukturave vendore dhe ofruesve të tjerë të licencuar si dhe promovimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm në ofrimin e ndihmës sociale.

Dokumenti mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030;
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026;
- Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024;
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;
- Ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale”;
- Ligjin nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësit social”;
- Aktet nënligjore që rregullojnë shërbime specifike si: VKM për standardet e shërbimeve për fëmijë, për PAK, për të moshuar, viktimat të dhunës, etj.;
- Konventa ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, si Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

3.1 Kuadri kushtetues dhe ligjor

Garantimi i shërbimeve sociale në Shqipëri mbështetet në parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në **Kreun V-Objektivat Socialë**, përmes **Neni 59**, shteti angazhohet të përmbushë detyrimet e tij ndaj qytetarëve në nevojë, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon. Këto objektiva përfshijnë promovimin e punësimit, sigurimin e të drejtës për strehim, aksesin në shërbime shëndetësore dhe arsim, përkujdesjen për të moshuarit, jetimët, invalidët dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës për shtresat më të cenueshme të shoqërisë. Ky kuadër normativ përbën themelin mbi të cilin ndërtohen politikat dhe programet për mbrojtjen sociale dhe përfshirjen e barabartë të qytetarëve në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Ligjet kryesore përfshijnë:

Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024;	Ky ligj vendos bazat e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke theksuar rolin qendror të bashkive në planifikimin, sigurimin dhe financimin e këtyre shërbimeve, si dhe në monitorimin e cilësisë dhe zbatimin e standardeve minimale.
Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”	Sanksionon se bashkitë kanë kompetencë ekskluzive për të ofruar dhe organizuar shërbime sociale për banorët e tyre. Neni 24 “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: 1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. 2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. 3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore. 4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e

	shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale”	Regullon ndihmën ekonomike dhe përfshirjen e bashkive në procesin e identifikimit, vlerësimit dhe miratimit të përfituesve të skemës së ndihmës.
Ligji nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësit social”	Vendos rregulla për profesionin e punonjësit social, përfshirë kriteret e edukimit, etikës dhe licencimit. Ky ligj lidhet drejtpërdrejt me standardet për personelin që ofron shërbime sociale.

3.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar

Shqipëria është palë nënshkruese dhe ratifikuese e disa konventave ndërkombëtare që ndikojnë drejtpërdrejt në politikëbërjen dhe standardizimin e shërbimeve sociale. Gjithashtu Shqipëria është në process të përafrimit të legjislacionit me BE në kuadër të procesit të antarësimit. Këto instrumente ndërkombëtare janë reflektuar në legjislacionin kombëtar dhe përbëjnë bazën për monitorim ndërkombëtar dhe përgjegjshmëri në zbatimin e të drejtave sociale.

Në konventat kryesore të ratifikuara nga shteti shqiptar mund të listojmë:

- **Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC)**

Kërkon ofrimin e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror dhe vendos standarde për trajtimin e fëmijëve në institucionet sociale.

- **Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (CRPD)**

Neni 19 thekson të drejtën për jetesë të pavarur dhe përfshirje në komunitet me mbështetjen e duhur.

3.3 Roli i Bashkisë dhe Strukturave të tyre në ngritjen e Shërbimeve Sociale

3.3.1 Kompetencat ligjore të bashkive

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, bashkitë kanë kompetencë ekskluzive për ofrimin e shërbimeve të kujdesit dhe ndihmës sociale në territorin e tyre. Konkretisht, bashkitë janë përgjegjëse për:

- Identifikimin e nevojave sociale të komunitetit
- Planifikimin dhe krijimin e shërbimeve të përshtatshme në nivel vendor
- Menaxhimin dhe financimin e shërbimeve
- Monitorimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me standardet kombëtare

Ky rol është i detyrueshëm dhe jo fakultativ, dhe është i lidhur ngushtë me mekanizmin e vlerësimit të performancës së njësive të vetëqeverisjes vendore.

3.3.2 Struktura përgjegjëse brenda bashkisë

Neni 36 i Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, përcakton qartë përgjegjësitë e bashkive në ofrimin dhe administrimin e shërbimeve sociale në territorin e tyre. Roli i bashkisë është shumëdimensional dhe fillon me identifikimin dhe vlerësimin e nevojave sociale, të cilat realizohen në bazë të hartës së vulnerabilitetit. Këto të dhëna përdoren më pas për të hartuar Planin Social Vendor, një dokument strategjik që përkthen nevojat në politika konkrete shërbimi.

Bashkia është përgjegjëse për programimin e buxhetit vendor dhe për përcaktimin e shportës bazë të shërbimeve shoqërore që duhet të ofrohen për komunitetin. Për realizimin e këtyre shërbimeve, ajo mund të kontraktojë ofrues të jashtëm përmes procedurave të prokurimit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, bashkia ka detyrimin të bashkërendojë punën me Shërbimin Social Shtetëror, për të siguruar që shërbimet të jenë të përputhshme me standardet kombëtare dhe të orientuara drejt nevojave reale të individëve.

Për të garantuar një administrim funksional, ligji parashikon ngritjen e strukturave të posaçme për kujdesin shoqëror brenda vetë bashkisë, si dhe njësi vlerësimi dhe referimi në çdo njësi administrative, në varësi të saj. Gjithashtu, parashikohet që për çdo 6,000 deri në 10,000 banorë të caktohet një punonjës social nga bashkia, për të siguruar mbulimin e duhur dhe përgjigje efektive ndaj nevojave sociale.

Nenet 47 dhe 48 të Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcaktojnë funksionimin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe rolin kyç të drejtuesit të saj.

Sipas Nenit 47, struktura për shërbimet shoqërore pranë bashkisë ka një mandat të gjerë që shtrihet përtej shërbimeve sociale të zakonshme. Ajo është gjithashtu organi kryesor për çështjet e mbrojtjes së fëmijës, duke ndërmarrë masa nëpërmjet koordinimit me drejtoritë e tjera bashkiake, mekanizmat vendorë të mbrojtjes, dhe institucione të tjera. Kjo strukturë raporton rregullisht kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak mbi situatën e fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Një funksion thelbësor i saj është ngritja e grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës, si në nivel bashkie, ashtu edhe në nivel të njësive administrative, duke koordinuar dhe mbikëqyrur aktivitetet e tij.

Ndërkohë, Neni 48 përcakton detyrat e drejtorit të kësaj strukture, i cili është autoriteti përgjegjës për marrjen e vendimeve mbi masat e mbrojtjes së fëmijëve, bazuar në vlerësimet e punonjësve të mbrojtjes së fëmijës dhe grupit teknik. Drejtori luan një rol kyç në miratimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve ndërsektoriale, në zbatim të Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe në organizimin e

shërbimeve emergjente të mbrojtjes 24-orëshe, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit. Po ashtu, ai është përgjegjës për prokurimin e shërbimeve që nuk mund të ofrohen nga strukturat shtetërore, për monitorimin e aksesit të fëmijëve në të drejta, dhe për raportimin periodik mbi veprimtarinë e njesisë së mbrojtjes së fëmijës.

Referuar Ligjit për barazinë gjinore në Shqipëri, organet e qeverisjes vendore bashkëpunojnë ngushtë me qeverinë qendrore dhe organizatat jofitimprurëse për zbatimin e politikave të barazisë gjinore në territorin që mbulojnë. Ata kryejnë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave lokale të ndara sipas gjinisë dhe emërojnë nëpunës përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, duke siguruar një mekanizëm efektiv koordinimi dhe monitorimi.

3.3.3 Parimet themelore në ofrimin e shërbimeve sociale

Shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore:

a) Parimi i universalitetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror janë krijuar, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në një sistem rregullash ligjore që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte.

b) Parimi i drejtësisë sociale. Çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat, për të cilët ka detyrim ligjor t'i mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.

c) Parimi i subsidiaritetit. Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.

ç) Parimi i mbështetjes shoqërore. Subjektet, të cilat përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, kanë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë.

d) Parimi i deinstitutionalizimit. Shërbimet e kujdesit shoqëror sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.

dh) Parimi i partneritetit. Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

e) **Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit.** Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij.


ë) **Parimi i mosdiskriminimit.** Ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

f) **Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.** Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësi social, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ruan konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, subjekt të këtij ligji, për të cilat ka marrë dijeni si pasojë e funksionit apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

3.4 Kategoritë e shërbimeve sociale

Bazuar në ligjet e marra në analizë dhe aktet nënligjore, bashkitë kanë detyrimin të ofrojnë këto lloje të shërbimeve sociale për grupet në nevojë:


A. Shërbime për fëmijët



Dokument referencë:

- ✓ Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, sidomos nenet 32-39, që parashikojnë shërbimet për fëmijët në nevojë për mbrojtje, kujdes alternativ dhe përfshirje sociale.
- ✓ Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, përcaktojnë detyrimet e bashkive për shërbimet për fëmijët.
- ✓ Udhëzimi nr. 6, datë 27.09.2016, “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në komunitet”, që përfshin standardet për qendrat ditore dhe shërbimet psiko-sociale.
- ✓ Udhëzimi nr. 33, datë 23.11.2017, “Për organizimin dhe funksionimin e mekanizmit të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor”, i cili rregullon shërbimet e mbrojtjes së fëmijës, përfshirë emergjencën dhe strehimin e përkohshëm.

B. Shërbime për persona me aftësi të kufizuara (PAK)




Dokument referencë:

- ✓ Ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, i cili përcakton të drejtën për shërbime sociale të përshtatura dhe gjithëpërfshirëse në komunitet.
- ✓ Ligji 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, sidomos nenet 6, 12, 16, 17, 22, 23, që detyrojnë bashkitë të ofrojnë shërbime për PAK sipas standardeve.

- ✓ Udhëzimi nr. 6, datë 27.09.2016, “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në komunitet”, që përfshin standardet për qendrat ditore dhe shërbimet e kujdesit në familje për PAK.
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 6.3.2019, “Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për përfitimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për PAK”.


C. Shërbime për të moshuarit



Dokument referencë:

- ✓ Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024 përcakton përgjegjësinë e bashkive për ofrimin e shërbimeve për të moshuarit, duke përfshirë kujdesin në banesë dhe strehimin afatgjatë.
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.05.2015, “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në institucione rezidenciale publike dhe jopublike për të moshuarit”.
- ✓ Udhëzimi nr. 6, datë 27.09.2016, “Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në komunitet” – përfshin edhe qendrat ditore dhe shërbimet në banesë për të moshuarit.
- ✓ Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030, e cila thekson zgjerimin e shërbimeve komunitare për të moshuarit, veçanërisht për ata pa mbështetje familjare.
- ✓ Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar – thekson nevojën për mbështetje për shtresat vulnerabël, përfshirë të moshuarit.

D. Shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit



Dokument referencë:

- Ligj Nr.9669, Datë 18.12.2006 “Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare” (i ndryshuar)
- VKM Nr. 327, Datë 2.06.2021 “Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës Ndërmjet Autoriteteve Përgjegjëse për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, si dhe Procedimin e tij për Mbështetjen e Rehabilitimin e Viktimave të Dhunës”

3.5 Modalitetet e ofrimit të shërbimeve

Shërbimet e kujdesit shoqëror, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe jopublike.


- **Në shërbimet shoqërore publike** përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet vendore të organeve të qeverisjes vendore.
- **Shërbimet jopublike** klasifikohen në shërbime fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Shërbimet shoqërore fitimprurëse nuk mund të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit dhe ai i bashkive. Shërbimet shoqërore jofitimprurëse gëzojnë të drejtën të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit apo ai i bashkive, vetëm nëse kanë lidhur kontratë me subjektin që ka përgjegjësi për të ofruar shërbimin e kujdesit shoqëror. Në shërbimet shoqërore jopublike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore ose në shtëpi nga subjekte jopublike.
- **Shërbimet shoqërore të specializuara** janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ofrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe nga njësitë e qeverisjes vendore në nivel qarku.

3.6 Kërkesa ligjore për profesionistët socialë

Sipas Ligjit nr. 163/2014 “Për urdhrin e punonjësit social” dhe Ligjit 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, çdo shërbim social duhet të ketë të paktën një punonjës social të licencuar, i cili është përgjegjës për vlerësimin, planifikimin, ndjekjen dhe dokumentimin e ndërhyrjeve. Punonjësit socialë duhet të jenë të diplomuar në fushën përkatëse dhe të kenë licencë aktive nga Urdhri i Punonjësit Social. Në rastin e shërbimeve për fëmijë, përfshihet edhe psikologu me përvojë në çështje të mbrojtjes së fëmijëve.

3.7 Prioritetet në zgjerimin e hartës së shërbimeve

Bashkia Kolonjë ka prioritet zgjerimin e hartës së shërbimeve me shërbimet:




4. Analiza e të dhënave

4.1 Numri i popullsisë sipas gjinisë

Sipas të dhënave më të fundit demografike, numri total i banorëve në Bashkinë Kolonjë është **7,519 banorë**, me një shpërndarje të përafërt gjinore prej 3,809 meshkuj dhe 3,710 femra.

Emri i Njesise Administrative	Numri i banoreve sipas gjinisë	Vlera
Ersekë	Femer	1428
	Mashkull	1394
Qendër Ersekë	Femer	932
	Mashkull	1009
Qendër Leskovik	Femer	76
	Mashkull	97
Novoselë	Femer	87
	Mashkull	111
Barmash	Femer	117
	Mashkull	129
Mollas	Femer	548
	Mashkull	548
Çlirim	Femer	48
	Mashkull	56
Leskovik	Femer	474
	Mashkull	465

Numri i banoreve sipas gjinisë



4.2 Vështrim i përgjithshëm

Në kuadër të vlerësimit të situatës sociale në territorin e Bashkisë Kolonjë, janë identifikuar gjithsej **983 individë** që përballen me një ose më shumë forma cenueshmërie sociale. Këta individë përfaqësojnë kategori të ndryshme që, për shkak të kushteve ekonomike, shëndetësore apo sociale, kanë nevojë për ndërhyrje të strukturuar përmes sistemit të mbrojtjes dhe përkujdesjes sociale.

Ky numër duhet analizuar në kontekstin e faktorëve që ndikojnë në nivelin e cenueshmërisë në territor, si struktura demografike e plakur, përhapja e varfërisë, prania e personave me aftësi të kufizuara, si dhe dukuritë sociale si dhuna në familje, papunësia apo fragmentimi i familjeve. Gjithashtu, migracioni i brendshëm dhe emigracioni ndërkombëtar kanë ndikuar ndjeshëm në reduktimin e popullsisë së qëndrueshme, duke e bërë edhe më të rëndësishëm identifikimin dhe adresimin e nevojave reale në komunitet.

Grupet e identifikuara si në nevojë për shërbime janë të shumëllojshme dhe përfshijnë:

- **Personat me aftësi të kufizuara** (fizike, mendore dhe shqisore), që kërkojnë mbështetje të personalizuar dhe përfshirje të qëndrueshme në jetën komunitare;
- **Fëmijët në rrezik dhe pa kujdes prindëror**, të cilët kanë nevojë për mbrojtje të vazhdueshme dhe ndërhyrje sociale;
- **Të moshuarit pa përkujdesje**, për të cilët nevojiten shërbime të posaçme të kujdesit në shtëpi apo qendra ditore;
- **Familjet me të ardhura të pamjaftueshme**, të cilat shpesh përballen me vështirësi ekonomike të zgjatura dhe mungesë aksesit në tregun e punës;
- **Viktimat e dhunës në familje**, që përballen me sfida të shumëfishta dhe kanë nevojë për mbështetje të integruar ligjore, psikologjike dhe strehimore;
- **Komunitetet rom dhe egjiptian**, që ndonëse nuk rezultojnë aktualisht të regjistruar në territorin e bashkisë, përfshihen si kategori prioritare sipas politikave kombëtare të përfshirjes sociale;
- **Personat me varësi nga substancat psikoaktive dhe familjet e fragmentuara pas divorcit**, të cilat shpesh mbeten të paintegruara në rrjetin e shërbimeve ekzistuese.

Kjo situatë reflekton një kompleksitet të lartë të nevojave sociale në nivel vendor dhe nënvizon domosdoshmërinë për ndërtimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të integruar në ofrimin e shërbimeve. Hartimi i planeve të ndërhyrjes duhet të mbështetet në analiza të sakta të shpërndarjes gjeografike dhe karakteristikave të grupeve vulnerabël, në mënyrë që burimet njerëzore, infrastrukture dhe financiare të orientohen aty ku nevoja është më e madhe. Po ashtu, përmirësimi i bashkëpunimit ndërinstitutional dhe forcimi i mekanizmave të referimit janë thelbësore për rritjen e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve sociale në Bashkinë Kolonjë.

5. Individë në Nevojë për Shërbime dhe Shërbimet Egzistuese

5.1 Individë që përfitojnë Ndhimë Ekonomike sipas njësive administrative

Në analizën e shpërndarjes territoriale të individëve përfitues të ndihmës ekonomike, rezulton se Bashkia Kolonjë ka një përqendrim të ndjeshëm të përfituesve në disa njësi administrative të caktuara, çka tregon për dallime të theksuara në nivelin e varfërisë brenda territorit të saj.

Dy njësitë administrative me numrin më të lartë të përfituesve janë:

- **Qendër Ersekë me 169 individë** dhe
- **Mollas me 164 individë.**

Këto njësi përfaqësojnë qendra të rëndësishme banimi brenda bashkisë dhe njëkohësisht janë zonat ku varfëria është më e dukshme dhe ku kërkesa për mbështetje ekonomike është më e lartë. Kjo sugjeron që në këto njësi, përveç ndihmës ekonomike, është e domosdoshme të zhvillohen edhe programe aktive të përfshirjes sociale dhe fuqizimit ekonomik, për të nxitur daljen nga varfëria.

Në vijim të listës renditen:

- **Ersekë me 98 individë,**
- **Leskovik me 53,**
- **Novoselë me 49,** dhe
- **Barmash me 37 përfitues.**

Ndërkohë, dy njësitë me përfitueshmëri më të ulët janë:

- **Çlirim me 26 individë,** dhe
- **Qendër Leskovik me vetëm 1 individ** të regjistruar si përfitues.

Kjo shpërndarje tregon një profil të ndryshëm ekonomik midis zonave periferike dhe qendrave administrative. Ndërsa në disa zona numri i individëve të mbështetur është relativisht i ulët, kjo mund të lidhet jo vetëm me përmasa më të vogla të popullsisë, por edhe me mungesën e informimit, vështirësitë në aksesin e shërbimeve apo hezitimin për të aplikuar në skemat e ndihmës ekonomike.

Për pasojë, bashkia duhet të ketë një **qasje të diferencuar territoriale** në planifikimin e ndërhyrjeve, duke kombinuar ndihmën ekonomike me masa që synojnë fuqizimin socio-ekonomik të familjeve, përmes:


- formimit profesional,
- mbështetjes në punësim,
- përfshirjes në ekonominë sociale,
- dhe shërbimeve të integruara të kujdesit social.





Njësitë si Mollas dhe Qendër Ersekë kërkojnë ndërhyrje të thelluara për uljen e varfërisë, ndërsa zonat me përfitues të pakët duhet monitoruar për të siguruar se mungesa e përfitimit nuk vjen si rezultat i barrierave strukturore në aksesin ndaj skemës.

Individë përfitues të ndihmës ekonomike sipas Njësive Administrative (Bashkia Kolonjë)



5.2 Individë përfitues sipas gjinisë

Grafiku më poshtë tregon shpërndarjen gjinore të individëve që përfitojnë ndihmë ekonomike në Bashkinë Kolonjë:

- **304 femra** përfitojnë ndihmë ekonomike,



- **293 meshkuj** janë gjithashtu përfitues.

5.3 Individë përfitues sipas grupmoshës

Shpërndarja sipas grupmoshës tregon se pjesa dërrmuese e përfituesve të ndihmës ekonomike në Bashkinë Kolonjë i përket grupmoshës aktive 19–64 vjeç (68.5%), çka nënvizon nevojën për orientim të politikave publike drejt punësimit, fuqizimit ekonomik dhe përfshirjes sociale. Një pjesë e konsiderueshme prej 28.6% janë fëmijë, të cilët jetojnë në familje përfituese të ndihmës ekonomike – ky tregues nënvizon rrezikun e trashëgimisë së varfërisë ndërbreznore, duke kërkuar masa të integruara për përkujdesje, edukim dhe mbrojtje sociale për fëmijët. Nga ana tjetër, vetëm 2.9% janë mbi 65 vjeç, çka mund të shpjegohet me mbulimin e kësaj kategorie përmes skemave të tjera si pensionet e pleqërisë, ose me nënraportim.

5.4 Familjet aplikuese të ndihmës ekonomike

Gjatë vitit 2024, në territorin e Bashkisë Kolonjë kanë aplikuar për përfitimin e ndihmës ekonomike **99 familje** të shpërndara në të gjitha njësitë administrative të bashkisë nga të cilat 63 përfituese. Të dhënat tregojnë një **ndarje të pabarabartë territoriale**, duke reflektuar qartë nivelin e ndryshëm të kërkesës për mbështetje ekonomike në komunitet, i cili lidhet me faktorë të ndryshëm si përmasat e popullsisë, niveli i varfërisë, shkalla e informimit dhe funksionimi i mekanizmave lokalë të ndihmës. Faktorë ndikues për këtë shpërndarje është numri i popullsisë në zona të caktuara dhe madhësia e zonave të banimit.

Zonat me aplikueshmërinë më të lartë:

- **Qendër Ersekë (26 aplikime)** dhe **Ersekë (21 aplikime)** janë zonat me numrin më të lartë të familjeve që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike. Këto dy njësi përfaqësojnë qendra urbane të bashkisë, me dendësi më të lartë popullore, por gjithashtu me problematika të theksuara sociale dhe ekonomike që kërkojnë vëmendje të shtuar institucionale.
- **Mollas (19 aplikime)** dhe **Leskovik (14 aplikime)** vijojnë me shifra të konsiderueshme, duke sinjalizuar nivele të qëndrueshme të nevojës për mbështetje në këto zona rurale të thella.

Zonat me aplikueshmëri të ulët:


- **Çlirim (2 aplikime)** dhe **Qendër Leskovik (1 aplikim)** paraqesin numrin më të ulët të aplikimeve. Kjo mund të interpretohet si rezultat i një popullsie më të vogël, largësia nga qendra urbane.

5.5 Familjet përfituese të ndihmë ekonomike

Sipas të dhënave të mbledhura nga Bashkia Kolonjë, në total janë **224 familje** të cilat përfitojnë aktualisht nga skema e ndihmës ekonomike. Këto familje janë të shpërndara në të gjitha njësitet administrative të bashkisë, me përqendrim të ndryshëm, çka pasqyron kontekstin social dhe ekonomik të secilës zone.

Shpërndarja territoriale:

- **Mollas (58 familje)** dhe **Qendër Ersekë (56 familje)** përfaqësojnë njësitet me përqindjen më të lartë të përfituesve, duke treguar një nivel të lartë të varfërisë apo të kushteve të pafavorshme ekonomike që justifikojnë përfshirjen në skemë, duke e lidhur me numrin më të lartë të banorëve për këto Njësi, krahasuar me njësitet më të vogla.
- Pas tyre vijnë **Ersekë (43 familje)** dhe **Leskovik (27 familje)**, që gjithashtu paraqiten si zona me ngarkesë të ndjeshme sociale, duke qenë se janë qytete dhe kanë të përqëndruar numrin më të madh të popullsisë banuese.
- Njësitet e tjera si **Novoselë (19 familje)**, **Barmash (12)** dhe **Çlirim (8)** kanë një numër më të vogël përfituesish, por jo përjashtues nga nevoja për mbështetje të vazhdueshme. Numri më i vogël i përfituesve lidhet me numrin e banorëve rezidentë dhe zonën e thellë malore, duke sjellë lëvizshmëri më të kufizuar drejt qendrave urbane ose drejt kërkesës për shërbime.
- **Qendër Leskovik** paraqitet me vetëm **1 familje përfituese**, çka mund të lidhet me përmasat shumë të vogla të popullsisë ose me kushte më të qëndrueshme ekonomike në këtë njësi.



5.6 Karakteristikat e familjeve përfituese nga ndihma ekonomike

5.6.1 Familje me gra kryefamiljare

Janë identifikuar gjithsej **27 familje** në të gjithë territorin e Bashkisë Kolonjë që drejtohen nga gra. Kjo kategori është më e përqendruar në:


- **Qendër Ersekë** – 8 raste
- **Mollas** – 6 raste
- **Ersekë** – 6 raste
- Njësitë e tjera si **Barmash, Çlirim, Novoselë, Leskovik** dhe **Qendër Leskovik** kanë nga 1–2 raste.

Këto të dhëna sugjerojnë për nevojën për politika të fuqizimit ekonomik të grave, sidomos në zonat me urbanizim të ndërmjetëm dhe të lartë (Ersekë, Qendër Ersekë, Mollas), ku gratë mbajnë më shpesh barrën e drejtimit të familjes.

5.6.2 Familje me deri në 2 fëmijë të mitur

Në territorin e Bashkisë Kolonjë janë identifikuar gjithsej **82 familje** përfituese të ndihmës ekonomike që kanë deri në 2 fëmijë të mitur. Kjo kategori paraqet një përqindje të lartë të barrës sociale, pasi lidhet drejtpërdrejt me nevojën për mbështetje për fëmijët dhe përkushtimin prindëror.

Shpërndarja gjeografike është si më poshtë:



Kjo shpërndarje tregon se familjet e reja me fëmijë të mitur janë më të përqendruara në zonat më të urbanizuara si **Ersekë, Mollas dhe Qendër Ersekë**, të cilat kanë edhe më shumë mundësi qasjeje ndaj institucioneve arsimore dhe shërbimeve mbështetëse. Këto zona duhet të jenë në fokus të ndërhyrjeve për mbështetje të drejtpërdrejtë për fëmijët (ushqim, edukim, shërbime shëndetësore).

5.6.3 Familje Rome ose Egjiptiane

Nga të dhënat e raportuara për familjet përfituese të ndihmës ekonomike në Bashkinë Kolonjë, rezulton se vetëm **2 familje** janë të përkatësisë **Rome ose Egjiptiane**, dhe të dyja këto ndodhen në **njësinë administrative Ersekë**.

Të gjitha njësitë e tjera – përfshirë **Mollas, Qendër Ersekë, Çlirim, Leskovik, Novoselë, Barmash dhe Qendër Leskovik** – **nuk kanë asnjë rast të raportuar** në këtë kategori. Ky numër shumë i ulët mund të interpretohet në disa mënyra:

- Ka një përfaqësim realisht shumë të vogël të komunitetit rom dhe egjiptian në këtë territor.

- Ose, më së shumti, **ka një nënraportim** apo **mosidentifikim të saktë** të përkatësisë etnike në sistemin e regjistrimit të përfituesve.


Për këtë arsye, rekomandohet:

- Rivlerësimi i mënyrës së identifikimit të përkatësisë etnike në regjistrat vendorë.
- Sigurimi i qasjes së barabartë në informacion dhe procedura për përfitimin nga skemat e mbështetjes sociale.

5.6.4 Familje me të paktën një anëtar me Aftësi të Kufizuara (PAK)

Në total, në Bashkinë Kolonjë janë identifikuar **22 familje përfituese** të ndihmës ekonomike që kanë në përbërje të tyre **të paktën një anëtar me aftësi të kufizuara (PAK)**. Kjo kategori është një nga më të cenueshmet në aspektin ekonomik, shëndetësor dhe të përfshirjes sociale, dhe shpërndarja e tyre në territor ndihmon në identifikimin e zonave me nevoja më të theksuara për mbështetje të specializuar.

Shpërndarja sipas njësive administrative është si më poshtë:



Zona urbane e Ersekës përmban përqindjen më të lartë të familjeve me persona me aftësi të kufizuara, gjë që mund të lidhet me dy faktorë kryesorë:

1. **Densiteti më i lartë i popullsisë** dhe për rrjedhojë edhe mundësi më të mëdha identifikimi dhe regjistrimi.

2. Akses më i mirë në strukturat e referimit dhe institucionet sociale apo shëndetësore.

Në zonat rurale si Barmash, Çlirim dhe Qendër Leskovik nuk rezulton të ketë raste të raportuara, kjo lidhur me faktin e numrin e ulët të familjeve aplikuese dhe përfituese në krahasim me numrin total të popullsisë në këto zona.

5.6.5 Familje me të paktën një pjesëtar në moshë pensioni

Në Bashkinë Kolonjë janë identifikuar gjithsej **14 familje përfituese** të ndihmës ekonomike që kanë në përbërje **të paktën një anëtar në moshë pensioni**. Kjo kategori përfaqëson një shtresë me rrezik të lartë të varfërisë, sidomos kur pensionet janë të ulëta ose mungojnë burimet e tjera të të ardhurave.

Shpërndarja sipas njësive administrative është si më poshtë:

- **Qendër Ersekë** – 5 raste
- **Mollas dhe Ersekë** – nga 4 raste secila
- **Barmash** – 1 rast
- **Të gjitha njësitë e tjera (Çlirim, Leskovik, Novoselë, Qendër Leskovik)** – **0 raste të raportuara**

Shifrat tregojnë se nevoja për përkujdesje sociale për të moshuarit është më e theksuar në zonat urbane dhe gjysmë-urbane, ku ka një përqendrim më të madh popullsie dhe ku shpesh të moshuarit jetojnë të vetmuar ose në kushte ekonomike të vështira. Ndërkohë, mungesa e rasteve në disa njësi mund të tregojë kërkesa më të ulta nga kjo kategori për përfitimin e ndihmës ekonomike krahas pensionit.

6. Strehimi Social

6.1 Numri i familjeve aplikuese për strehim social

Të dhënat tregojnë se në total **35 familje** kanë aplikuar për strehim social. Shpërndarja gjeografike tregon qartë se kërkesa për strehim është **përqendruar në zonat urbane dhe qendrore**, kryesisht në:

- **Ersekë**: 16 aplikime (45% e totalit)
- **Qendër Ersekë**: 11 aplikime
- **Leskovik**: 5 aplikime
- **Mollas**: 3 aplikime

Sipas ndarjes gjinore, kemi: **10 aplikues femra dhe 25 meshkuj.**

Ndërsa në njësitë si **Çlirim, Barmash, Novoselë dhe Qendër Leskovik**, nuk ka asnjë aplikim, gjë që mund të interpretohet si:

- Mungesë informimi apo akses ndaj shërbimeve;
- Migrim i lartë i popullsisë në këto zona;

6.2 Numri i aplikuesve për strehim që janë edhe përfitues të ndihmës ekonomike

Nga 35 aplikues, **vetëm 9 familje** janë edhe përfituese të ndihmës ekonomike, që përfaqëson **26%** të totalit.


- Kjo tregon se një pjesë e konsiderueshme e kërkesave për strehim vjen edhe nga familje që nuk klasifikohen si përfituese të ndihmës ekonomike, por që mund të jenë në rrezik përjashtimi social (p.sh. të ardhura të pamjaftueshme, qira të papërballueshme, pensionistë, gra kryefamiljare, familje rome-egjiptiane, etj.).
- **Ersekë** kryeson edhe këtu me 5 raste, ndjekur nga **Qendër Ersekë (3)** dhe **Mollas (1)**.

Sipas ndarjes gjinore, kemi: **3 aplikuese femra dhe 6 meshkuj.**

6.3 Godina me infrastrukturë të përshtatshme për shërbime komunitare

Të dhënat tregojnë një **mangësi ekstreme të infrastrukturës sociale**, pasi:

- Vetëm **një godinë** në gjithë territorin (në qytetin **Ersekë**) ka infrastrukturë të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve komunitare.
- **Të gjitha njësitë e tjera kanë vlerë zero**, çka nënkupton se komunitetet nuk kanë qendra sociale, hapësira për shërbime këshillimi, edukimi, ndihmë për familjet vulnerabël etj.



6.4 Familje përfituese sipas programeve të strehimit

Nga të gjitha programet e strehimit të parashikuara në nivel vendor, **vetëm dy prej tyre rezultojnë të jenë aktivë dhe me përfitues konkretë:**

- **Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese** (18 përfitues)
- **Programi i banesave sociale me qira** (14 përfitues)

1. Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese

Ky program rezulton të ketë numrin më të lartë të përfituesve (18 raste), duke reflektuar ndoshta një nevojë të madhe në komunitet për ndërhyrje në banesa të amortizuara ose që nuk plotësojnë kushtet minimale të jetesës.

Ky program ka një rëndësi të veçantë për familjet që zotërojnë banesa në gjendje të keqe, por që nuk kanë mundësi financiare për t'i rehabilituar. Ndërhyrjet e tilla ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetës, shëndetit dhe sigurisë së familjeve në nevojë.

2. Programi i banesave sociale me qira

Me 14 përfitues, ky program gjithashtu paraqitet aktiv dhe i domosdoshëm për adresimin e nevojave të individëve apo familjeve pa strehë, me të ardhura të ulëta, ose që ndodhen në situata të vështira sociale.

Zbatimi i tij sugjeron se bashkia ka një fond aktiv banesash sociale ose është angazhuar në sigurimin e tyre përmes skemave të qirasë së subvencionuar.

Ky program është kyç për garantimin e të drejtës për strehim për grupet më të marginalizuara, duke reduktuar rrezikun e pastrehësisë dhe duke rritur përfshirjen sociale.

7. Punëkërkesit e papunë në Bashkinë Kolonjë

7.1 Punëkërkesit e papunë sipas njësive administrative


Të dhënat e mbledhura mbi **numrin e punëkërkesve të papunë** tregojnë një shpërndarje të pabarabartë të fenomenit të papunësisë brenda njësive administrative të bashkisë. Në total, janë regjistruar **135 punëkërkes të papunë**, me përqendrim të dukshme në disa zona specifike.

Njësitë me numër të lartë punëkërkesish:

- **Ersekë** mban vendin e parë me **46 punëkërkes të papunë**, duke reflektuar një përqendrim të lartë të personave në kërkim të punës në zonën urbane. Si qendër administrative, kjo mund të lidhet me migrimin e brendshëm nga zonat rurale drejt qytetit në kërkim të mundësive më të mira ekonomike.
- **Qendër Ersekë**, me **43 punëkërkes**, ndjek nga afër, duke treguar se sfidat e punësimit janë të përhapura edhe në zonat përreth qytetit kryesor.
- **Mollas**, me **24 punëkërkes**, përfaqëson një njësi rurale me nivel të lartë papunësie, çka sugjeron mungesë të mundësive ekonomike dhe nevojë për ndërhyrje të drejtpërdrejtë për nxitjen e punësimit lokal.

Njësitë me nivel të ulët punëkërkesish:

- **Barmash (1), Qendër Leskovik (2) dhe Novoselë (4)** paraqesin numra më të ulët, të cilët mund të interpretohen në disa mënyra:
 - Popullsia më e vogël dhe e shpërndarë, që reflekton automatikisht një numër më të ulët punëkërkesish.
 - Mundësi informale punësimi, që nuk regjistrohen si punëkërkes zyrtarë.
 - Mungesë qasjeje ndaj zyrave të punës dhe informacionit për regjistrim, veçanërisht në zonat më të largëta dhe rurale.




7.2 Punëkërkesit e papunë sipas Gjinisë

Të dhënat tregojnë se **meshkujt përbëjnë rreth 65% të punëkërkesve të papunë**, ndërsa femrat përfaqësojnë rreth 35%. Ky raport mund të tregojë se:

- Burrat janë më të përfshirë në sektorë me punësim sezonal ose

informal, të cilët preken më shpejt nga papunësia.

- Femrat mund të mos raportohen si punëkërkuese për arsye sociale, kulturore apo familjare (p.sh., kujdes për fëmijët), edhe pse realisht janë jashtë tregut të punës.



Në analizën e Planit Social ose të politikave aktive të punësimit, **është e rëndësishme të merren parasysh dallimet gjinore**, për të ndërtuar masa të drejta dhe gjithëpërfshirëse.

7.3 Grupet Vulnerabël të Punëkërkuessve të Papunë

Të dhënat tregojnë një **pjesëmarrje të ulët ose të papërfaqësuar** të disa kategorive të veçanta në tregun e punës, konkretisht:

- Rome/Egjiptianë – 0 punëkërkuess të papunë të regjistruar:**
Kjo mungesë e të dhënave nuk duhet interpretuar si mungesë nevojë për punësim, por më shumë si **mungesë përfshirjeje në sistemin formal të punësimit**. Shpesh, anëtarët e këtyre komuniteteve nuk regjistrohen në zyrat e punës për shkak të:
 - Mungesës së informacionit dhe aksesit;
 - Mosbesimit ndaj institucioneve publike;
 - Apo angazhimit në ekonomi informale apo të vetëpunësuar jo të formalizuar.
- Kryefamiljare gra – 8 punëkërkuess:**
Ky grup përfaqëson një ndër kategoritë më të rrezikuara nga marginalizimi social dhe ekonomik. Kryefamiljaret gra shpesh përballen me barriera të shumta për punësim, përfshirë:

- Mungesë mbështetjeje për kujdesin ndaj fëmijëve;
 - Mungesë trajnimesh ose njohurish për tregun e punës;
 - Diskriminim gjinor në aksesin ndaj vendeve të punës.
- **Emigrantë – 1 punëkërkues:**
Ky numër shumë i ulët mund të sinjalizojë një grup të vogël të pranishëm në komunitet, por gjithashtu edhe një **mosregjistrim të emigrantëve që janë në kërkim pune**, shpesh për shkak të statusit të paformalizuar apo mungesës së dokumentacionit të plotë.
 - **Persona me aftësi të kufizuara (PAK) – 1 punëkërkues:**
Edhe pse përfaqësimi është minimal, ky numër tregon që ekziston një individ me Aftësi të Kufizuara që është aktivisht në kërkim pune. Sidoqoftë, **mungesa e mbështetjes së strukturuar, punëve të përshtatura dhe barrierave sociale** e bën pjesëmarrjen e PAK-ve në tregun e punës shumë të vështirë.

7.4 Trajnimet Profesionale

Zyra e punës ka organizuar gjithsej **3 trajnime profesionale** gjatë periudhës raportuese (2024), me një **pjesëmarrje prej 41 individësh**, që përbën një mesatare prej rreth 14 pjesëmarrës për trajnim. Kjo tregon një angazhim pozitiv në drejtim të ngritjes së kapaciteteve të punëkërkuesve dhe përgatitjes së tyre për tregun e punës.

Sipas ndarjes gjinore, kemi: 23 përfituese femra dhe 19 meshkuj.

Këto trajnime përfaqësojnë një instrument të rëndësishëm për:

- Rritjen e mundësive për punësim, veçanërisht për personat pa arsim profesional ose me përvojë të kufizuar pune;
- Fuqizimin ekonomik të grupeve vulnerabël, nëse trajnimet janë të orientuara drejt nevojave të tyre;
- Ndërveprimin me sektorin privat, nëse programet zhvillohen në partneritet me punëdhënës potencialë.

7.5 Bizneset në territorin e Bashkisë Kolonjë

1. Formalizimi i bizneseve

Nga 244 biznese gjithsej, **207 janë biznese të vogla të regjistruara formalisht**, që përbën një përqindje të lartë të formalizimit në segmentin e bizneseve të vogla (~85%). Kjo tregon një **nivel të mirë të regjistrimit dhe deklarimit fiskal**.

2. Prezenca e informalitetit

Janë evidentuar **10 biznese informale**, që megjithëse përfaqësojnë një përqindje relativisht të ulët (~4%), përbëjnë një sinjal për **monitorim të mëtejshëm** dhe ndërhyrje për edukim dhe mbështetje për legalizim.

3. Qarkullimi i bizneseve

Me 28 biznese të mbyllura brenda një viti, përkundër 230 të regjistruarave deri në fund të vitit, tregohet një **nivel i caktuar lëvizshmërie ekonomike**, që mund të jetë pasojë e vështirësive në mjedisin ekonomik lokal, mungesës së tregut, apo kushteve të tjera operacionale.


4. Fushat kryesore të aktivitetit

Aktiviteti ekonomik është i **koncentruar kryesisht në sektorin e shërbimeve**:

- **Bar-Kafe**

- **Ushqimore**

Kjo reflekton strukturën konsumatore të territorit dhe mungesën e diversifikimit ekonomik në fusha të tjera si prodhimi, bujqësia përpunuese apo turizmi rural.



Të dhënat mbi shpërndarjen e bizneseve sipas njësive administrative në Bashkinë Kolonjë tregojnë një përqendrim të lartë në zonën urbane të **Ersekës**, me **167 biznese të regjistruara**, që përfaqësojnë mbi 68% të totalit të bizneseve në territor. Kjo është tregues i qartë i rolit të Ersekës si qendër ekonomike dhe administrative.

Në zonat rurale si **Mollas (13 biznese)**, **Qendër Leskovik (14 biznese)** dhe **Leskovik (39 biznese)**, ekziston një aktivitet modest ekonomik, ndërsa njësitë si **Çlirim** dhe **Novoselë** nuk raportojnë asnjë biznes të regjistruar, duke sinjalizuar për përjashtim ekonomik dhe nevojë për politika mbështetëse që nxisin sipërmarrjen.

Kjo shpërndarje e pabarabartë e bizneseve sugjeron nevojën për ndërhyrje të synuara për të mbështetur zhvillimin ekonomik në zonat më pak të zhvilluara, përmes subvencioneve, lehtësive fiskale apo ngritjes së qendrave mbështetëse për biznesin.

8. Personat me Aftësi të Kufizuara

8.1 Identifikimi dhe Vlerësimi i Nevojave të Personave me Aftësi të Kufizuara


Procesi i identifikimit dhe vlerësimit të nevojave të personave me aftësi të kufizuara realizohet nëpërmjet hartimit të planeve individuale të mbështetjes, të cilat plotësohen në bashkëpunim me grupet përkatëse të punës pranë strukturave vendore të shërbimeve sociale.

Këto plane përfaqësojnë një mjet të rëndësishëm për vlerësimin holistik të situatës së individit, duke evidentuar nevojat e tij specifike në fusha të ndryshme si:

- kujdesi shëndetësor,
- arsimimi dhe formimi profesional,
- punësimi i mundshëm,
- akses në infrastrukturë,
- shërbime psikosociale dhe mbështetje në komunitet.

Nëpërmjet këtij mekanizmi, bëhet e mundur ndërtimi i një qasjeje të personalizuar, e cila synon të garantojë jo vetëm mbrojtjen sociale, por edhe përfshirjen aktive dhe dinjitoze të individit në jetën komunitare.

8.2 Karakteristikat e Aftësisë së Kufizuar



Të dhënat e mbledhura tregojnë një shpërndarje të konsiderueshme dhe të larmishme të personave me aftësi të kufizuara (PAK) në të gjitha njësitë administrative të bashkisë. Këta persona janë klasifikuar në tre kategori kryesore:

- Persona me probleme shikimi,
- Persona paratetraplegjik (me dëmtime të rënda motorike),
- Persona me aftësi të kufizuara fizike ose mendore.

Përqendrimi më i lartë në qytetin e Ersekës dhe Qendrën e saj:

- Erseka paraqitet si njësi me numrin më të lartë të PAK-ve në të tria kategoritë:
 - 29 persona me probleme shikimi,
 - 13 persona paratetraplegjik,
 - 52 persona me aftësi të kufizuara fizike/mendore.
- E ndjek Qendra Ersekë, me:
 - 9 raste me probleme shikimi,
 - 4 raste paratetraplegjik,
 - 51 raste fizik/mendor.

Kjo tregon një përqendrim të lartë të rasteve në zonat urbane, ndoshta për shkak të aksesit më të mirë ndaj shërbimeve shëndetësore, regjistrimit dhe mbështetjes institucionale. Por në të njëjtën

kohë, këto të dhëna sinjalizojnë nevojën për shërbime të dedikuara, të strukturuar dhe të qëndrueshme për këtë kategori në këto zona.

Njësi rurale me numër të lartë PAK:

- Mollas ka gjithashtu një numër të konsiderueshëm të PAK-ve:
 - 8 me probleme shikimi,
 - 3 paratetraplegjik,
 - 22 fizik/mendor.
- Po ashtu edhe Leskoviku dhe Novosela kanë nga 21–22 raste me aftësi të kufizuara fizik/mendore dhe 5–8 raste me probleme shikimi.

Kjo tregon se edhe në zonat rurale ka prani të ndjeshme të personave me nevoja të veçanta, por që shpesh nuk kanë akses të barabartë në shërbime, qendra ditore apo mbështetje profesionale.

Njësi me përfaqësim më të ulët:

- Barmash ka numrat më të ulët në të tria kategoritë (vetëm 1 paratetraplegjik dhe 8 fizik/mendor, pa asnjë rast me probleme shikimi).
- Qendër Leskovik dhe Çlirim kanë gjithashtu përfaqësim të kufizuar.

Megjithatë, edhe në këto zona të vogla, prania e rasteve tregon nevojën për të siguruar akses minimal në shërbime, për të mos lënë askënd pas.

Sipas ndarjes gjinore, kemi: me probleme shikimi, 15 përfituese femra dhe 40 meshkuj

paratetraplegjik, 9 përfituese femra dhe 15 meshkuj


fizik/mendor, 162 përfituese femra dhe 167 meshkuj.

8.3 Shërbimi i strehimit social

Të dhënat tregojnë se vetëm një pjesë e kufizuar e personave me aftësi të kufizuara ka aplikuar për strehim social në nivel vendor. **Erseka (5 raste)** dhe **Leskoviku (3 raste)** kanë numrin më të lartë të aplikimeve, ndërsa **Mollas** dhe **Qendra Ersekë** kanë nga një rast. Në të gjitha njësitë e tjera (**Çlirim, Barmash, Novoselë, Qendër Leskovik**) nuk është regjistruar asnjë aplikim.

Kjo shpërndarje nënvizon nevojën për **informim dhe mbështetje më të mirë administrative** për PAK-të në zonat rurale, në mënyrë që të garantohet akses i barabartë në programet e strehimit social.

Sipas ndarjes gjinore, kemi: 2 aplikuese femra dhe 6 meshkuj.




8.4 Përfituesit nga skema e mbrojtjes sociale – Invalidët e Punës

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor 2024, **434 invalidë të punës** janë duke u trajtuar përmes **skemës së mbrojtjes sociale**. Ky numër përfaqëson një pjesë të rëndësishme të popullsisë në nevojë dhe nënvizon rolin kyç të sistemit të mbrojtjes sociale në garantimin e të ardhurave minimale dhe mbështetjes për kategori të cënueshme, si individët që kanë humbur aftësinë për të punuar për shkak të dëmtimeve fizike apo sëmundjeve të rënda. Kjo kategori prej janarit 2025 trajtohet me pagesë nëpërmjet skemës së sigurimeve shoqërore.

8.5 Shërbimi Shëndetësor

- **Qendrat shëndetësore** janë të pranishme vetëm në **Leskovik, Mollas dhe Qendër Ersekë**.
- **Ambulancat** janë struktura mbështetëse dominante në zonat rurale, me numër më të lartë në **Qendër Ersekë (11)** dhe **Mollas (6)**.
- **Poliklinika ekziston vetëm në qytetin e Ersekës**, duke e bërë atë një qendër të rëndësishme për shërbime më të specializuara.

Kjo shpërndarje tregon një mungesë të diversifikimit të strukturave në pjesën më të madhe të njësive, veçanërisht mungesë të qendrave shëndetësore dhe poliklinikave jashtë qendrave urbane.



8.5.1 Treguesit Kryesorë të Shëndetit në Bashkinë Kolonjë

Të dhënat e mbledhura për vitin 2024 paraqesin një pasqyrë të përgjithshme të sistemit lokal të kujdesit shëndetësor në Bashkinë Kolonjë. Ato evidentojnë disa aspekte pozitive, si edhe sfida që kërkojnë ndërhyrje dhe përmirësim.

Kapacitetet njerëzore dhe infrastrukturore

Në spitalin lokal janë të punësuar 51 profesionistë shëndetësorë (mjekë dhe infermierë), ndërsa kapaciteti i shtretërve është vetëm 27, duke sinjalizuar një raport të mirë personel/shtretër, por edhe një kufizim në kapacitetin stacionar për hospitalizime.

Mungesa e psikologëve aktivë në qendrat shëndetësore (0) përbën një boshllëk serioz, veçanërisht në kushtet e rritjes së problemeve të shëndetit mendor dhe zhvillimit tek fëmijët.

Treguesit e shëndetit publik

97% e fëmijëve janë të vaksinuar, çka tregon një nivel shumë të mirë të mbulimit me vaksinim dhe funksionim të qëndrueshëm të shërbimeve të kujdesit parësor për fëmijët.

Norma e vdekshmërisë foshnjore është 0, një arritje pozitive që tregon për efikasitetin e shërbimeve parësore dhe mbikëqyrjes neonatale.

Shëndeti riprodhues dhe shëndeti mendor

Janë regjistruar 202 vizita për shëndetin riprodhues, që sinjalizojnë një përdorim aktiv të këtyre shërbimeve, por edhe nevojën për promovim dhe zgjerim të tyre, sidomos për gratë dhe të rinjtë në zonat rurale.

100 raste të trajtuara me probleme të shëndetit mendor tregojnë prani të konsiderueshme të nevojave në këtë fushë, duke e bërë të domosdoshëm integrimin e shërbimeve psikosociale dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit për përballimin e këtyre problematikave.

Fëmijët me çrregullime zhvillimore

Janë identifikuar 4 fëmijë me autizëm dhe 3 me çrregullime të tjera zhvillimore, të cilët kërkojnë ndihmë të specializuar. Në mungesë të psikologëve dhe logopedëve në nivel vendor, ekziston rreziku i mostrajtit apo marginalizimit të këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre.

9. Viktima të dhunës në familje

9.1 Dhuna në Familje sipas Njërive Administrative

Të dhënat e raportuara nga Kordinatori vendor i dhunës në marrëdhënje familjare dhe Administratorët shoqërorë tregojnë se fenomeni i dhunës në familje është **kryesisht i përqendruar në zonën urbane të Ersekës**, ndërkohë që në shumicën e njësive të tjera administrative nuk është regjistruar asnjë rast.

- **Erseka** ka raportuar:
 - 8 raste të dhunës në familje,
 - 6 urdhra mbrojtjeje të lëshuara,
 - 2 urdhra të monitoruar.

Kjo tregon një përpjekje institucionale për t'iu përgjigjur rasteve të identikuara, por edhe një nevojë për forcimin e mekanizmave të mbrojtjes dhe mbikëqyrjes, sidomos në pjesën e monitorimit pas lëshimit të urdhrave.

- Në Qendër Ersekë është raportuar 1 rast, me 1 urdhër të lëshuar dhe të monitoruar, duke treguar një reagim të koordinuar, edhe pse në shkallë të vogël.
- Të gjitha njësitë e tjera (Leskovik, Çlirim, Mollas, Barmash, Novoselë, Qendër Leskovik) raportojnë 0 raste në të tre treguesit, çka ngre pikëpyetje për:
 - nënraportim të rasteve për shkak të mungesës së aksesit apo besimit të institucionet,

- ose mungesë të kapaciteteve për identifikimin dhe trajtimin e rasteve në zonat rurale.

Sipas ndarjes gjinore, kemi: 7 përfituese femra dhe 1 mashkull.

9.2 Mbështetje për Viktimat e Dhunës në Familje

Të dhënat tregojnë se mbështetja për viktimat e dhunës në familje në Bashkinë Kolonjë mbetet e kufizuar dhe e fragmentuar, me akses të pjesshëm në shërbime bazë.

- **6 viktima përfitojnë Ndihmë Ekonomike**, duke reflektuar përfshirjen e tyre në skemën e mbrojtjes sociale për të garantuar minimumin jetik.
- Po aq (**6 viktima**) kanë përfituar **shërbime emergjente**, si strehim i përkohshëm apo vendosje në struktura mbrojtëse (shelter), çka tregon se mekanizmi reaktiv funksionon në raste urgjente.

Megjithatë, disa boshllëqe thelbësore bien në sy:

- **Asnjë viktimë nuk ka përfituar strehim social afatgjatë**, duke rrezikuar kthimin në situata dhune pas përfundimit të mbrojtjes emergjente.
- **Asnjë viktimë nuk është punësuar**, çka reflekton mungesën e ndërhyrjeve për ri-integrim ekonomik dhe autonomi financiare, që janë çelës për dalje të qëndrueshme nga dhuna.
- **Asnjë viktimë nuk ka përfituar këshillim psikologjik apo ligjor nga bashkia**, një mangësi e theksuar në ofrimin e shërbimeve psikosociale, të cilat janë kritike për ripërfshirjen sociale dhe shëndetin mendor të viktimave.
- Vetëm **1 fëmijë përfitues** është raportuar në kuadër të mbështetjes për fëmijët e viktimave të dhunës – një tregues i ulët që mund të sinjalizojë mospërfshirje të fëmijëve në paketat mbrojtëse ose mungesë strukturash të dedikuara.

10. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

10.1 Numri i fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Sipas të dhënave të raportuara nga **Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve**, në territorin e Bashkisë Kolonjë janë identifikuar gjithsej **59 fëmijë në nevojë për mbrojtje/përkujdesje**, të shpërndarë në forma të ndryshme të cenueshmërisë:


- Fëmijë pjesë e familjeve përfituese nga ndihma ekonomike

- Fëmijë me aftësi të kufizuara
- Fëmijë të identifikuar nga strukturat lokale si në rrezik

Megjithëse kjo shifër ofron një panoramë të qartë të dimensionit të problematikës, vetëm një numër shumë i vogël i tyre (vetëm 5 raste) është realisht menaxhuar institucionalisht nga NJMF, duke nxjerrë në pah një boshllëk të thellë ndërmjet identifikimit dhe ndërhyrjes efektive.

Situata aktuale:

- Shumica e njësive administrative raportojnë prezencë të fëmijëve në rrezik, veçanërisht në:
 - **Qendër Ersekë (5 raste në përkujdesje),**
 - **Barmash dhe Ersekë (kombinim prej mbi 9 rastesh përkatëse).**
- **Vetëm 2 njësi** kanë raste të menaxhuara nga NJMF (Barmash dhe Qendër Ersekë), duke ngritur shqetësime për funksionimin e mekanizmit të ndërhyrjes.



Sipas ndarjes gjinore, kemi: 5 përfitues femra dhe 9 meshkuj.

10.2 Shërbimet për fëmijët në nevojë në Bashkinë Kolonjë

Në territorin e Bashkisë Kolonjë është funksionale qendra “**Foleza**, e cila ofron shërbimin e tipit “**Shtëpi familje**”, një formë kujdesi alternativ që synon të ofrojë një mjedis të sigurt dhe sa më afër modelit familjar për fëmijët pa përkujdesje prindërore.

Aktualisht, nga ky shërbim **përfitojnë 3 fëmijë**, të cilët janë strehuar dhe mbështetur përmes një forme të qëndrueshme përkujdesjeje, jashtë sistemit tradicional institucional.

Ky model i kujdesit, i bazuar në qasjen e personalizuar dhe afatin e mesëm/gjatë të qëndrimit, përbën një alternativë të vlefshme për fëmijët që përballen me situata të rënda sociale apo janë viktimë të braktisjes, dhunës apo neglizhencës.

10.3 Shërbimi i Kujdesit për Fëmijët e Moshës 0–3 vjeç (Çerdhja)

Numri i çerdheve në Bashkinë Kolonjë: 1

Kapaciteti maksimal: 18 fëmijë

Fëmijë të regjistruar aktualisht: 11


Bashkia Kolonjë ofron aktualisht vetëm **një çerdhe publike**, e cila mbulon kujdesin ndaj fëmijëve të moshës 0–3 vjeç. Çerdhja operon me një **shfrytëzim prej rreth 61% të kapacitetit**, çka tregon se ndonëse shërbimi është funksional, **nuk është i mbingarkuar**, por as i shfrytëzuar plotësisht.

Vlerësime dhe faktorë që ndikojnë në përdorimin e ulët të kapacitetit:

- Kapaciteti total është shumë i kufizuar për të mbuluar të gjithë territorin e bashkisë, veçanërisht për komunitetet rurale që janë larg qendrës ku ndodhet çerdhja.
- Migrimi i brendshëm dhe i jashtëm i familjeve të reja drejt qyteteve të mëdha ose jashtë vendit ka ndikuar në uljen e lindshmërisë dhe të popullsisë rezidente, duke ndikuar drejtpërdrejt në numrin e fëmijëve potencialë për këtë shërbim.
- Mungesa e transportit, mungesa e stafit të specializuar, apo ndonjëherë besimi i ulët i prindërve ndaj institucioneve publike të kujdesit, mund të kenë ndikuar gjithashtu në përdorimin më të ulët se sa kapaciteti maksimal.

10.4 Shërbimi i Arsimit Parashkollor

Në Bashkinë Kolonjë shpërndarja e institucioneve arsimore sipas njësive administrative tregon një prani të konsiderueshme të infrastrukturës shkollore dhe të arsimit parashkollor në të gjithë territorin. Bazuar në të dhënat e paraqitura, në Bashkinë Kolonjë funksionojnë 13 kopshte të shpërndara në zonat urbane dhe rurale të territorit të saj. Shpërndarja gjeografike e kopshtit tregon një përpjekje për të garantuar akses të barabartë në edukimin parashkollor, si në qendrat urbane ashtu edhe në zonat më të thella rurale.



Njesia Administrative	Numri i Kopshteve
Ersekë	2
Qendër Ersekë	6
Qendër Leskovik	0
Novoselë	1
Barmash	0
Mollas	3
Çlirim	0
Leskovik	1

Frekuentimi në kopshte

Në bashkinë Kolonjë, sipas të dhënave më të fundit, numri total i fëmijëve të moshës 3-6 vjeç është 151, prej të cilët 75 janë djem dhe 76 janë vajza. Nga kjo popullsi, 107 fëmijë ndjekin institucionet parashkollore (kopshtin), konkretisht 54 djem dhe 53 vajza.

Kjo përfaqëson një përqindje të përgjithshme prej 70.86% të fëmijëve që janë të përfshirë në arsimimin parashkollor. Megjithatë, 44 fëmijë ende nuk ndjekin kopshtin nga të cilët 21 janë djem dhe 23 janë vajza, duke treguar një boshllëk të rëndësishëm në përfshirje që kërkon vëmendje institucionale.


10.5 Shërbimi i arsimit parauniversitar

Në territorin e **Bashkisë** Kolonjë janë të shpërndara gjithsej 18 **institucione arsimore** të niveleve të ndryshme, të cilat mbulojnë të gjitha njësitë administrative urbane dhe rurale të bashkisë. Këto inatitucione përfaqësojnë një **rrjet të gjerë dhe të larmishëm të arsimit parauniversitar**.

Shkollat në territorin e Bashkisë janë të organizuara dhe të shpërndara në mënyrë të tillë që të mbulojnë sa më mirë nevojat arsimore të komunitetit. Ato klasifikohen në disa nivele sipas ciklit të edukimit që ofrojnë, duke përfshirë: shkolla fillore (8 gjithsej), shkolla 9-vjeçare (7 gjithsej) dhe shkolla të mesme (3 gjithsej).

- ✚ **Shkollat fillore** gjithsej 8 u shërbejnë fëmijëve në fazat e para të edukimit, duke u ofruar njohuritë bazë në lexim, shkrim, matematikë dhe lëndë të tjera themelore. Ato janë të përhapura në mënyrë të tillë që të jenë sa më pranë vendbanimeve për të siguruar akses të lehtë për nxënësit e vegjël.
- ✚ **Shkollat 9-vjeçare**, gjithsej 7 në numër, përfshijnë si ciklin fillor, ashtu edhe atë të mesëm të ulët, dhe janë projektuar për të ofruar një arsim të plotë bazë. Ato luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin akademik dhe shoqëror të nxënësve dhe përgatitjen e tyre për nivelin e ardhshëm arsimor.
- ✚ **Shkollat e mesme**, në numër prej 3, që përfshijnë gjimnazet dhe shkollat profesionale, janë institucione që synojnë të formojnë të rinjtë për studime të mëtejshme universitare apo për përgatitje për tregun e punës. Këto shkolla janë të vendosura në zona strategjike për të përfshirë një numër sa më të madh nxënësish nga zona të ndryshme të bashkisë.

Në tërësi, rrjeti arsimor i Bashkisë është konceptuar për të siguruar mundësi të barabarta arsimimi për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë, pavarësisht vendbanimit apo kushteve ekonomike.



Frekuentimi në arsimin fillor


Në arsimin fillor janë të regjistruar gjithsej 269, nga të cilët 140 janë djem dhe 129 vajza. Sipas të dhënave të raportuara, 52.04% e tyre janë djem dhe 47.96% vajza. Kjo ndarje reflekton situatën e përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi, në varësi të kushteve lokale, demografisë, dhe mundësive të ofruara në komunitet.

Gjinia	Numri i Nxënësve	Përqindja (%)
Djem	140	52.04
Vajza	129	47.96

Për të garantuar përfshirje të barabartë në arsimin fillor, rekomandohet që institucionet arsimore dhe Bashkia Kuçovë të vijnë përpara për të reduktuar çdo pabarazi që mund të vijë nga faktorë lokalë si distanca nga shkolla, infrastruktura e papërshtatshme, apo mungesa e mbështetjes familjare. Investimet në transport shkollor, përmirësimi i kushteve mjedisore të shkollave dhe fushatat ndërgjegjësuere për rëndësinë e edukimit fillor janë thelbësore për të rritur përfshirjen dhe për të siguruar arsim të aksesueshëm dhe cilësor për çdo fëmijë, pavarësisht gjinisë apo vendbanimit.

Frekuentimi arsimi 9-vjecar

Në arsimin 9-vjeçar janë të regjistruar gjithsej 281 nxënës, prej të cilëve 158 janë djem dhe 123 vajza. Sipas të dhënave, 56.23% e nxënësve janë djem dhe 43.77% janë vajza. Kjo shpërndarje pasqyron situatën aktuale të përfshirjes në këtë nivel arsimor, e cila ndryshon nga njësi në njësi dhe ndikohet nga faktorë të ndryshëm lokalë.



Rekomandohet një analizë më e thelluar e faktorëve që ndikojnë në pjesëmarrjen më të ulët të vajzave në arsimin 9-vjeçar, veçanërisht në zonat rurale apo më të thella. Mund të jetë e nevojshme të ndërmerren masa konkrete për të mbështetur vazhdimësinë arsimore të vajzave, përmes përmirësimit të kushteve të shkollave, ndihmës për transportin, fushatave për ndërgjegjësim të


komunitetit, si dhe përfshirjes së familjeve në mbështetje të edukimit të vajzave. Këto ndërhyrje janë të rëndësishme për të siguruar akses dhe përfshirje të barabartë në arsimin bazë për të gjithë fëmijët

Pavarësisht variacioneve, këto të dhëna nënvizojnë rëndësinë e monitorimit të rregullt të pjesëmarrjes së fëmijëve në arsim dhe nevojën për politika që mbështesin vazhdimësinë e shkollimit për të gjithë. Sigurimi i kushteve të favorshme për ndjekjen e arsimit 9-vjeçar është thelbësor për garantimin e një zhvillimi të qëndrueshëm dhe të barabartë për çdo fëmijë.

Frekuentimi arsimi i mesëm

Në arsimin e mesëm janë të regjistruar gjithsej 233 nxënës, nga të cilët 116 janë djem dhe 117 vajza, përkatësisht 49.79% djem dhe 50.21% vajza. Ndarja gjinore në këtë nivel arsimor pasqyron situatën e raportuar për njësinë përkatëse, por këto përqindje mund të jenë të ndryshme në zona të tjera. Shpërndarja e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm ndikohet nga faktorë të shumtë si zgjedhjet individuale, mundësitë për të ndjekur shkolla të përgjithshme apo profesionale, si dhe faktorë socialë, ekonomikë apo kulturorë. Kjo e bën të nevojshme që të mbështetet përfshirja e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse në këtë nivel të rëndësishëm të arsimit.

Ky ekuilibër pozitiv duhet të ruhet dhe të përforcohet përmes politikave të qëndrueshme që mbështesin arsimimin e të rinjve pavarësisht gjinisë. Rekomandohet vijimi i masave që sigurojnë kushte të përshtatshme mësimore, mbështetje psikosociale dhe orientim në karrierë për të gjithë nxënësit, si dhe përfshirje më e madhe e familjes dhe komunitetit në procesin edukativ. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbajtjes së vajzave në shkollë në zona rurale, për të garantuar vazhdimësinë e këtij progresi gjinor edhe në të ardhmen.



10.6 Shërbimet Psiko-Sociale në Shkollë

Në shkollat e Bashkisë Kolonjë, shërbimi psiko-social nuk ofrohet nga ana e vetë bashkisë, por është i pranishëm përmes strukturave të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP). Kjo do të thotë se përgjegjësia për mbulimin e nevojave psiko-emocionale të nxënësve është aktualisht jashtë kompetencës direkte të bashkisë, duke e kufizuar mundësinë për ndërhyrje të shpejtë, të integruar dhe të qëndrueshme në nivel vendor.

Ky boshllëk ndër-institucional është veçanërisht problematik për fëmijët në situata vulnerabël, të cilët kanë nevojë për mbështetje të menjëhershme, të koordinuar dhe të shumëplanëshme psiko-sociale.

10.7 Masat lehtësuese të Bashkisë për fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

Bashkia Kolonjë ka ndërmarrë disa masa sociale mbështetëse që synojnë lehtësimin e barrës ekonomike për familjet dhe përkujdesjen për fëmijët vulnerabël:

- **Përfshirja nga tarifa e çerdhes dhe kopshtit**, një masë që ndihmon në përfshirjen e hershme të fëmijëve në institucionet edukative dhe ndihmon familjet me të ardhura të ulëta.
- **Mbështetje me pajisje shkollore, ushqime dhe veshmbathje**, veçanërisht për fëmijët që janë pjesë e familjeve me ndihmë ekonomike ose në situata të rrezikut social.

11.Familjet rome dhe egjiptiane

11.1 Madhësia e grupit dhe shtrirja në territor


Në lidhje me komunitetin rom dhe egjiptian në territor, të dhënat mbi ta nuk janë të disponueshme, nuk kemi një statistikë të rifreskuar me të dhëna aktuale. Nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Social, do bëhen përpjekje për ndritjen e një databaze të dhënash, në mënyrë që kjo kategori të jetë e identifikuar dhe më në vëmendje për përfitimin e shërbimeve.

11.2 Shërbimet për familjet rome dhe egjiptiane

Për familje dhe individë nga këto komunitete, ofrohet shërbimi i ndihmës ekonomike, pagesa e bonusit të qirasë, prioritet për programet e punësimit të referuara nga familje apo individë përfitues nga skema e shërbimeve shoqërore në bashki. Ndihma humanitare sipas rasteve.

12.Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale

12.1 Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale sipas njësive administrative



Grafiku tregon shpërndarjen e kërkesave për shërbime sociale nga të moshuarit në nivel njësie administrative, sipas pesë nënkategorive kryesore:

1. Shërbim në familje

2. Shërbim në qendër ditore
3. Shërbim rezidencial
4. Strehim social
5. Përfitues të ndihmës ekonomike

Nga të dhënat e paraqitura:

- **Erseka** paraqet nivelin më të lartë të kërkesave, sidomos për **shërbim në qendër ditore** (29 raste) dhe për **ndihmë ekonomike** (4 raste). Kjo tregon se nevojat për mbështetje ditore dhe ekonomike janë më të theksuara në këtë njësi.
- **Qendra Ersekë** ka gjithashtu kërkesa të konsiderueshme për **shërbim në qendër ditore** (4 raste) dhe **ndihmë ekonomike** (5 raste), duke treguar një profil të ngjashëm me Ersekën.
- **Mollas** ka 4 përfitues nga **ndihma ekonomike**, por mungojnë kërkesat për shërbime të tjera, çka mund të sinjalizojë mungesë informacioni ose qasje të kufizuar ndaj shërbimeve.
- **Barmash** ka vetëm 1 të moshuar që përfiton ndihmë ekonomike dhe mungesë kërkesash për lloje të tjera të mbështetjes.
- **Leskovik** ka vetëm 2 raste për **shërbim në qendër ditore**, ndërsa të gjitha kategoritë e tjera janë bosh.
- Në njësitë administrative **Çlirim dhe Novoselë** nuk rezultojnë të dhëna mbi të moshuarit në nevojë për shërbime sociale. Ky boshllëk mund të sinjalizojë mungesë të raportimit apo të identifikimit të nevojave, dhe për pasojë sugjerohet realizimi i një vlerësimi proaktiv në terren për të garantuar mbulim të barabartë të komunitetit të të moshuarve.

Nuk raportohet asnjë kërkesë për shërbim rezidencial apo strehim social në asnjë njësi – kjo mund të sinjalizojë mungesë strukture mbështetëse për shërbim afatgjatë ose mungesë të vetëdijesimit mbi ekzistencën e këtyre mundësive. **Shërbimi në familje**, megjithëse është një alternativë e rëndësishme për të moshuarit e vetmuar, nuk është kërkuar fare në asnjë njësi – një boshllëk i dukshëm në politikën e kujdesit social.

12.2 Shërbimet e kujdesit shoqëror për të moshuarit

Ofrohet shërbimi i qendrës ditore për të moshuar.

13. Personat me varësi nga droga dhe nga alkooli

Për këtë kategori, nuk janë raportuar të dhëna nga njësitë administrative ose nga strukturat përkatëse të shërbimit social. Kjo mungesë informacioni mund të interpretohet në disa mënyra:

- Mungesë e rasteve të identifikuara ose të raportuara në territorin e bashkisë;
- Nënraportim i rasteve për shkak të stigmatizimit social, mungesës së mekanizmave të identifikimit apo mungesës së strukturave të specializuara për trajtim dhe ndjekje;

- Mungesë ndërveprimi ndërinstitutional, veçanërisht me qendrat shëndetësore, mjekët e familjes apo strukturat arsimore që mund të sinjalizojnë raste të tilla.

Rekomandohet të zhvillohen mekanizma më të mirë të identifikimit të hershëm, bashkëpunim më i ngushtë me shërbimet shëndetësore dhe edukative, si dhe ndërgjegjësim i komunitetit dhe familjeve për të reduktuar stigmat dhe për të ndihmuar në evidentimin dhe mbështetjen e rasteve të varësisë nga droga dhe alkooli.

14. Migrantët dhe Emigrantët

Nga të dhënat e mbledhura rezulton se vetëm një migrant është raportuar në Njësinë Administrative Novoselë, ndërsa për njësitë e tjera administrative nuk janë raportuar të dhëna. Kjo situatë ngre disa çështje që meritojnë vëmendje:

- Mungesa e rasteve të raportuara nuk nënkupton domosdoshmërisht mungesë të nevojës, por mund të jetë pasojë e mungesës së identifikimit aktiv, migrimit sezonal, apo migrimit të heshtur pa ndjekur procedura të regjistrimit pranë strukturave lokale.
- Shifrat e ulëta mund të lidhen edhe me faktin që shumë familje migrante/emigrante nuk kërkojnë ndihmë pranë institucioneve vendore ose nuk e perceptojnë bashkinë si një aktor që mund t'i ndihmojë në procesin e riintegrit.

Llojet e Shërbimeve që Ofron Bashkia për Migrantët/Emigrantët:

Sipas informacionit të siguruar nga strukturat vendore të shërbimit social, Bashkia ofron disa forma mbështetjeje për migrantët/emigrantët dhe familjet e tyre, si:

- Ofrimi i ndihmës ekonomike – për individët/familjet që përmbushin kriteret ligjore;
- Referim për punësim ose përfshirje në kurse profesionale – përmes bashkëpunimit me Zyrat e Punës dhe ofrues të tjerë të trajnimeve;
- Pagesa e bonusit të qirasë – në rastet kur migrantët/emigrantët kthehen dhe nuk kanë një banesë të qëndrueshme;
- Subvencionimi i interesave të kredisë – si lehtësim për familjet që kanë vështirësi ekonomike në procesin e strehimit apo përballimit të shpenzimeve jetike.

Rekomandime:

- Nevojitet **rritje e kapaciteteve të strukturave vendore** për të identifikuar dhe ndjekur më mirë nevojat e kësaj kategorie.

- Sugjerohet përfshirja e **komunitetit lokal, punonjësve shëndetësorë dhe arsimorë** në sinjalizimin e rasteve dhe në ofrimin e informacionit mbi të drejtat dhe shërbimet ekzistuese për migrantët/emigrantët.
- Krijimi i një **mekanizmi regjistrimi dhe ndjekjeje** për individët e kthyer nga emigracioni apo në lëvizje migratore, për të garantuar akses më të mirë në shërbime

15. Shërbimet Bazë që ofron Bashkia Kolonjë

Referuar standardeve minimale kombëtare bashkia duhet të ofrojë shërbimet:

1. Shërbime për fëmijët dhe familjet

- Identifikimi dhe menaxhimi i rasteve të rrezikut për fëmijët (në përputhje me Ligjin 18/2017)
- Mbështetje psiko-sociale për fëmijë dhe prindër
- Shërbime për parandalimin e braktisjes dhe përkujdes alternativ (streha, kujdestari, birësim)
- Përfshirje në procesin e mbrojtjes dhe edukimit të hershëm

2. Shërbime për personat me aftësi të kufizuara (PAK)

- Shërbime për mbështetje në arsim, punësim dhe lëvizshmëri
- Referim për vlerësim funksional dhe plane individuale mbështetëse

3. Shërbime për të moshuarit

- Aktivitete sociale dhe interaktive në qendra komunitare
- Identifikimi i të moshuarve të vetmuar dhe ndihmë për nevojat bazike

4. Shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

- Shërbime të menjëhershme mbështetëse (psikolog, jurist, transport)
- Referim në strehë të mbrojtura ose qendra emergjente
- Këshillim për rindërtim të jetës dhe pavarësi ekonomike
- Koordinimi i rasteve përmes mekanizmit të referimit

5. Shërbime për persona në situatë rreziku social

- Qendra komunitare multifunktionale (për fëmijë, të rinj, gra)
- Strehim emergjent për persona të pastrehë
- Shërbime për përdorues të substancave apo persona me çrregullime mendore
- Ndihmë për të dalë nga varfëria ekstreme dhe integrim në komunitet

6. Shërbime të koordinimit dhe menaxhimit të rasteve

- Zyrë e shërbimit social në bashki, me punonjës social dhe psikolog
- Regjistër i rasteve, sistem i dokumentimit dhe raportimit
- Ndërtimi i planit individual të ndërhyrjes për çdo rast
- Monitorim dhe ndjekje periodike

Bashkia Kolonjë ka funksionale:

Shërbimi	Forma minimale	Burimi Ligjor	Po/Jo/Pjesërisht
Zyrë shërbimesh sociale	1 PS + 1 Psikolog	Ligji 121/2016	Jo
Menaxhim rastesh për fëmijë	Mekanizëm referimi	Ligji 18/2017	Po
Shërbim për PAK	Qendër ditore ose home-care	VKM 1074/2015	Jo
Mbështetje për të moshuar	Vizita shtëpie ose klub social	VKM 821/2006	Qendër ditore
Ndihmë për viktimat e dhunës	Strehë, referim, psikolog	Ligji 9669/2006	Pjesërisht
Rrjet referimi vendor	Strukturë ndërsektorale	Udhëzim nr. 10/2018	Po

Bashkia	Shërbimet funksionale në Bashki	Shërbimet e nevojshme për tu ngritur në bashki
Kolonjë	- Shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat; - Shërbimet shoqërore në situatë emergjence; - Shërbimi në qendër ditore për të moshuar	- shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit; - shërbimet e specializuara; - shërbimi i këshillimit me telefon ose on-line.

Fusha e Shërbimit	Aktualisht ekziston? (Po/Jo)	Planifikohet të zhvillohet	Nevojat për mbështetje (burime njerëzore, financiare, teknike)qeveria qendrore/OJF.
Zyrë e shërbimit social me staf të kualifikuar	PO		Trajnim + Burime njerëzore
Menaxhim i rasteve të fëmijëve në risk	PO		
Shërbime për personat me aftësi të kufizuara (PAK)	JO	PO	Burime njerëzore + financiare
Shërbime për të moshuarit	PO	PO	Shërbim në familje (burime financiare)

Shërbime për viktimat e dhunës në familje	PO		Burime njerëzore (psikolog)
Qendra komunitare për grupe vulnerabël	JO	PO	Qendër zhvillimi për personat PAK(burime financiare + njerëzore)
Strehim emergjent për persona në nevojë	PO		
Shërbime për përdorues të substancave ose me çrregullime mendore	JO	JO	
Sistem dokumentimi dhe ndjekje e rasteve	PO		
Rrjet referimi ndërsektorial vendor	PO		

16. Kapacitetet e bashkisë

Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të Bashkisë Kolonjë tregojnë për kapacitete të kufizuara administrative dhe profesionale në ofrimin e shërbimeve sociale. Aktualisht, në territorin e bashkisë operon vetëm **1 Punonjës i Mbrojtjes së Fëmijëve (PMF)** në njësinë administrative të Ersekës, çka është një kapacitet minimal në raport me nevojat territoriale dhe kategoritë në risk.

Në strukturë janë të përfshirë **4 Administratorë Shoqërorë**, por mungon një **Njësi për Vlerësimin dhe Referimin e Nevojave (NJVNR)**, e cila është thelbësore për identifikimin dhe ndërlidhjen efektive të rasteve me shërbimet përkatëse. Kjo përbën një sfidë kritike për menaxhimin cilësor të rasteve dhe për zbatimin e qasjes së integruar në mbrojtje sociale.

Kapaciteti ligjor i bashkisë përfaqësohet nga **3 juristë**, ndërkohë që nuk ka asnjë mjek të përfshirë në strukturat e brendshme.

Në lidhje me shërbimet që bashkia menaxhon direkt, ato përkufizohen vetëm në **shërbime shoqërore në situatë emergjence**, ndërkohë që mungojnë struktura dhe instrumente për ofrimin e shërbimeve të rregullta ose të specializuara për kategori të ndryshme në nevojë.

Sfida kryesore e identifikuar është **mungesa e NJVNR**, ndërsa **prioriteti i renditur** është **përmirësimi i shërbimeve sociale ekzistuese dhe zgjerimi i tyre**, përmes ngritjes së kapaciteteve institucionale, rritjes së stafit të specializuar dhe krijimit të strukturave funksionale për koordinimin ndërinstitutional. Këto masa janë të domosdoshme për të garantuar një mbulim të drejtë dhe efektiv të nevojave të komunitetit në të gjitha njësitë administrative të bashkisë.

17. Vizioni dhe Misioni

17.1 Vizioni

Të garantohet akses i barabartë, gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm në shërbimet sociale për çdo qytetar në territorin e Bashkisë Kolonjë, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës, uljen e përjashtimit social dhe fuqizimin e grupeve në nevojë, në përputhje me vlerat komunitare, realitetin lokal dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

17.2 Misioni

Bashkia Kolonjë, përmes zbatimit të Planit Vendor Social, angazhohet të zhvillojë dhe ofrojë politika dhe shërbime sociale efektive, të integruara dhe të orientuara drejt nevojave reale të komunitetit, duke vendosur në qendër qytetarin, fuqizimin e grupeve vulnerabël, bashkëpunimin ndërinstitutional dhe përfshirjen aktive të aktorëve vendorë e partnerëve socialë, në funksion të një sistemi social gjithëpërfshirës, të drejtë dhe reagues.

18. Qëllimet dhe Objektivat

QËLLIMI 1: Zbutja e varfërisë dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për individët dhe familjet në nevojë, me fokus të veçantë tek personat me aftësi të kufizuara, përmes ofrimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve të tjera sociale në mënyrë të drejtë, transparente, të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të përshtatshme për t'u përballur me situata krizash apo emergjencash.

- **Objektivi 1.1:** Përmirësimi i riintegritit social dhe ekonomik të individëve përfitues të ndihmës ekonomike, përmes referimit aktiv drejt punësimit, formimit profesional dhe nxitjes së ndërmarrjeve sociale në nivel vendor.
- **Objektivi 1.2:** Rritja e kapaciteteve të bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe në mënyrë të drejtë nevojave të individëve dhe familjeve vulnerabël, përmes ofrimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve financiare në situata krizash dhe emergjencash.
- **Objektivi 1.3:** Përmirësimi i aksesit dhe përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe komunitare, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe mbështetëse të përshtatshme, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse nga strukturat vendore.
- **Objektivi 1.4:** Rritja e mbështetjes për të moshuarit në nevojë përmes shërbimeve sociale dhe komunitare të qëndrueshme, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse.

QËLLIMI 2: Parandalimi dhe eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme, përmes një qasjeje të koordinuar, parandaluese dhe gjithëpërfshirëse.

- **Objektivi 2.1:** Fëmijët rriten në një mjedis mbështetës, me praktika pozitive të prindërimit, që i mbrojnë nga dhuna dhe abuzimi.
- **Objektivi 2.2:** Funksionimi efektiv i një sistemi vendor të mbrojtjes së fëmijëve, gjithëpërfshirës, i koordinuar dhe i dobishëm për identifikimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve të riskut.
- **Objektivi 2.3:** Parandalim i dhunës në familje, rehabilitim dhe fuqizim për viktimat e dhunës
- **Objektivi 2.4:** Përmirësimi i cilësisë, efektivitetit dhe përshtatshmërisë së shërbimeve komunitare sociale në nivel vendor, në përputhje me standardet kombëtare dhe nevojat e grupeve në situatë vulnerabilitet.

19. Plani i Veprimit

QËLLIMI 1: Zbutja e varfërisë dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për individët dhe familjet në nevojë, me fokus të veçantë tek personat me aftësi të kufizuara, përmes ofrimit të ndihmës ekonomike dhe përfitimeve të tjera sociale në mënyrë të drejtë, transparente, të ndjeshme ndaj gjinisë dhe të përshtatshme për t'u përballur me situata krizash apo emergjencash.

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi 1.1: Përmirësimi i riintegritit social dhe ekonomik të individëve përfitues të ndihmës ekonomike, përmes referimit aktiv drejt punësimit, formimit profesional dhe nxitjes së ndërmarrjeve sociale në nivel vendor.						
A1.1.1 Nxitja, lehtësimi dhe mbështetja e të rinjve (vajza dhe djem, nga zonat rurale dhe urbane) nga familjet përfituese të ndihmës ekonomike për arsim, formim, këshillim dhe punësim, përmes identifikimit dhe referimit të tyre. (lidhja me garancinë rinore);	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, AKPA, SHSSH	2026 2027 2028	Numri i të rinjve (vajza dhe djem) përfitues të ndihmës ekonomike që janë identifikuar dhe referuar nga bashkia drejt shërbimeve të arsimit; formimit profesional; këshillimit; dhe punësimit.	Bashkia, parteritet me dhe AKPA SHSSH	0	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve
A1.1.2 Zhvillimi dhe zbatimi nga bashkia i formave të mbështetjes për punësim dhe vetëpunësim të përfituesve të ndihmës ekonomike në moshë	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve,	2027 2028	Numri i përfituesve të ndihmës ekonomike në moshë pune që	Bashkia, parteritet me dhe AKPA SHSSH	0	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve

pune, veçanërisht në zonat rurale, me qëllim daljen graduale nga skema; me fokus të veçantë tek gratë dhe vajzat, prindërit e vetëm dhe nënat kryefamiljare, për të reduktuar barrën e punës së papaguar dhe të kujdesit.	AKPA, SHSSH	janë referuar drejt masave për punësim, formim ose vetëpunësim. (gra/burra) Numri i grave dhe vajzave përfituese të NE që janë përfshirë në skema punësimi ose vetëpunësimi. Numri i nënave kryefamiljare dhe prindërve të vetëm që kanë dalë nga skema si rezultat i përfshirjes në punësim ose ndërmarrje të vogla. Numri i masave mbështetëse të ndërmarra nga bashkia (trajtime, grante të vogla, partneritete me			
--	--------------------	---	--	--	--

			OJF/OShC) për punësim të përfituesve të NE.			
A1.1.3. Organizimi i fushatave lokale të ndërgjegjësimit, në bashkëpunim me Zyrat e Punës dhe partnerë të tjerë, për të informuar komunitetin – veçanërisht grupet në nevojë (gra, të rinj, PAK, prindër të vetëm) – mbi mundësitë e punësimit, formimit profesional dhe afatet e mbështetjes.	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, AKPA, SHSSH	2026 2027 2028	Numri i fushatave të ndërgjegjësimit të organizuara nga bashkia në bashkëpunim me Zyrën e Punës dhe/ose partnerë të tjerë lokalë. Numri i pjesëmarrësve në fushata, të ndarë sipas gjinisë dhe grupeve të targetuara (gra/vajza, të rinj, PAK, prindër të vetëm). Numri i referimeve të bëra pas fushatave drejt shërbimeve të punësimit ose	Bashkia, parteritet me dhe AKPA SHSSH	0	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve

			formimit profesional. Përqindja e fushatave të realizuara në zonat rurale nga total fushatave. Numri i materialeve informuese të shpërndara (fletëpalosje, posterë, njoftime dixhitale).			
A1.1.4 : Rritja e kapaciteteve të personelit të sektorit të shërbimeve sociale në nivel vendor	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Partneritet me organizata joqeveritare	2026 2027 2028	Numri i aktiviteteve të trajnimit dhe ngritjes së kapaciteteve të realizuara për stafin e shërbimeve sociale të bashkisë. Numri i punonjësve të përfshirë në trajnim (administratorë,	Bashkia, OJF, Donatorë	0	Zv.Kryetari

			punonjës NJVRN, punonjës të mbrojtjes së fëmijës, etj.). Përqindja e stafit të sektorit të shërbimeve sociale që kanë marrë pjesë në të paktën një aktivitet formimi gjatë vitit. Numri i moduleve tematike të trajtuara (vlerësim i nevojave, ndjeshmëri gjinore, menaxhim rastesh, etj.). Përqindja e pjesëmarrësve që raportojnë përmirësim të njohurive pas përfundimit të			
--	--	--	--	--	--	--

			trajnim.			
A1.1.5. Rishikimi periodik i Planit Social	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Drejtoria e Buxhetit	2026 2027 2028	Numri i rishikimeve zyrtare të Planit Social të realizuara gjatë periudhës 3-vjeçare. Numri i raporteve të monitorimit dhe zbatimit të Planit Social të përgatitura nga bashkia. Përqindja e masave të Planit Social të vlerësuara nëpërmjet monitorimit dhe rishikimit. Numri i konsultimeve të organizuara me aktorë lokalë dhe komunitetin për rishikimin e Planit.	Bashkia	0	Zv.Kryetari

			Numri i masave të përmirësuara, shtuar ose përshtatur në Plan pas rishikimit.			
--	--	--	---	--	--	--

Objektivi 1.2: Rritja e kapaciteteve të bashkisë për t'iu përgjigjur në kohë dhe në mënyrë të drejtë nevojave të individëve dhe familjeve vulnerabël, përmes ofrimit të ndihmës ekonomike.

A1.2.1. Ngritja e Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore	2026	NJVNR e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore;	38,594,400	Zv.Kryetari
A1.2.2. Rritja e kapaciteteve të stafit të bashkisë për menaxhimin e rasteve emergjente sociale, përmes trajnimeve të dedikuara dhe krijimit të një databaze vendore për personelin e trajnuar.	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Sektori i Emergjencave Civile	2027 2028	Numri i trajnimeve të organizuara për personelin e bashkisë mbi menaxhimin e rasteve emergjente sociale. Numri i punonjësve të shërbimeve sociale që kanë marrë pjesë në trajnimet për emergjencat. Përqindja e stafit të sektorit të shërbimeve sociale të trajnuar për reagimin në situata emergjente. Ekzistenca e një databaze funksionale dhe të përditësuar të personelit të trajnuar për raste emergjente. Numri i përditësimeve të databazës së personelit të trajnuar të realizuara nga bashkia gjatë periudhës së Planit.	0	Zv.Kryetari
Objektivi 1.3:Përmirësimi i aksesit dhe përfshirjes sociale të personave me aftësi të kufizuara në jetën publike dhe komunitare, përmes ofrimit të shërbimeve sociale dhe mbështetëse të përshtatshme, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse nga strukturat vendore.					
A1.3.1. Rritja e kapaciteteve të strukturave vendore për zbatimin e reformës së vlerësimit biopsiko-social të	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe	2027 2028	Numri i punonjësve të përfshirë në	Bashkia, parteritet me SHSSH	0 Zv. Kryetari

personave me aftësi të kufizuara, përmes forcimit të burimeve njerëzore, trajnimeve për miradministrim dhe ndërtimit të mekanizmave të monitorimit dhe vlerësimit në nivel vendor.	Edukimit të Fëmijëve, SHSSH	strukturat e vlerësimit biopsiko-social që janë trajnuar nga bashkia. Ekzistenca e një strukture funksionale të vlerësimit biopsiko-social në bashki. Numri i vlerësimeve biopsiko-sociale të kryera nga strukturat e bashkisë gjatë vitit. Numri i mekanizmave të monitorimit të procesit të vlerësimit të ngritur në bashki (formularë, raporte, takime koordinimi). Përqindja e rasteve të vlerësuara që janë ndjekur me plan shërbimi dhe referim të mëtejshëm.			
---	------------------------------------	--	--	--	--

A1.3.2. Zgjerimi dhe përmirësimi i mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara (PAK) në nivel vendor, përmes ofrimit dhe lehtësimit të aksesit në shërbime shoqërore, shëndetësore, arsimore, si dhe programe të formimit të aftësive për jetesë të pavarur dhe punësim.	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, SHSSH, AKPA, DAR, OSHKSH	2027 2028	Numri i PAK-ve që kanë përfituar shërbime të mbështetjes përmes strukturave të bashkisë (sociale, shëndetësore, arsimore, formim/punësim). Numri i llojeve të shërbimeve mbështetëse të ofruara për PAK në territorin e bashkisë. Përqindja e PAK-ve të identifikuar nga bashkia që janë lidhur me të paktën një shërbim mbështetës. Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione publike ose OJF për ofrimin e shërbimeve për PAK. Numri i rasteve të PAK-ve që kanë	Bashkia, parteritet me SHSSH, AKPA, DAR, OSHKSH	0	Zv. Kryetari
---	--	----------------------	--	--	----------	---------------------

			përfituar mbështetje për përfshirje në arsim ose formim profesional.			
A1.3.3. Forcimi i Mekanizmit Vendor të Referimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (PAK), përmes menaxhimit të integruar të rasteve nga ekipe multidisciplinare, krijimit të profileve individuale të PAK, dhe zbatimit të protokolleve për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale, me fokus të veçantë tek gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara që përballen me dhunë gjinore.	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, AKPA, SHSSH	2026 2027 2028	Numri i rasteve të PAK-ve të trajtuara nga Mekanizmi Vendor i Referimit përmes menaxhimit të integruar të rastit. Numri i profileve individuale të PAK-ve të krijuara dhe të pasuruara nga ekipet multidisciplinare. Numri i protokolleve të miratuara dhe të zbatuara për rastet e PAK, përfshirë mbrojtjen nga dhuna. Numri i rasteve të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara të identifikuar si viktima të dhunës që kanë përfituar ndërhyrje të koordinuara për	Bashkia, parteritet me SHSSH, AKPA, DAR, OSHKSH	0	Zv. Kryetari

			mbrojtje dhe mbështetje. Numri i takimeve funksionale të Mekanizmit të Referimit për menaxhimin e rasteve të PAK.			
Objektivi 1.4: Rritja e mbështetjes për të moshuarit në nevojë përmes shërbimeve sociale dhe komunitare të qëndrueshme, të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse.						
A 1.4.1: Ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes në shtëpi për të moshuarit e vetmuar dhe në pamundësi fizike	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, partneritet me OJF apo qendra shëndetësore.	2027 2028	Numri i të moshuarve përfitues / numri i vizitave mujore / % e rasteve të ndjekura rregullisht.	Bashkia	0	Zv. Kryetari
A 1.4.2: Krijimi i hapësirave komunitare për të moshuarit në çdo njësi administrative (kënd social)	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, partneritet me OJF	2027 2028	Numri i hapësirave funksionale / numri i pjesëmarrësve në muaj.	Bashkia	0	Zv. Kryetari
A 1.4.3: Fushata ndërgjegjësimi për mbështetjen e të moshuarve nga komuniteti dhe familja, nëpërmjet shkollave, qendrave komunitare, rrjeteve të të rinjve, etj. Fokus: edukimi ndërbreznor dhe rritja e ndjeshmërisë	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve	2026 2027 2028	Numri i fushatave / materialeve informuese / pjesëmarrësve të angazhuar.	Bashkia	0	Zv. Kryetari

sociale.						
----------	--	--	--	--	--	--

QËLLIMI 2: Parandalimi dhe eliminimi i të gjitha formave të dhunës, shfrytëzimit, abuzimit dhe praktikave të dëmshme, përmes një qasjeje të koordinuar, parandaluese dhe gjithëpërfshirëse.

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I FINANCIMIT	KOSTO	MONITORIMI
Objektivi 2.1 Fëmijët rriten në një mjedis mbështetës, me praktika pozitive të prindërimit, që i mbrojnë nga dhuna dhe abuzimi.						
A.2.1.1. Hartimi dhe zbatimi i një plani vendor të komunikimit dhe ndërgjegjësimit, i shoqëruar me materiale informuese dhe edukuese, për të adresuar normat dhe sjelljet negative që lidhen me dhunën dhe abuzimin ndaj fëmijëve, duke përfshirë edhe çështjen e martesave të hershme.	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, partnerë	2026 2027	Plani i komunikimit i përgatitur dhe miratuar nga bashkia. Numri i produkteve me mesazhe sensibilizuese të përgatitura dhe shpërndara. Numri i personave të informuar ose të përfshirë në aktivitetet e ndërgjegjësimit.	Bashkia; Donatorë	0	Zv.Kryetari
A.2.1.2 Zhvillimi dhe zbatimi i trajnimeve mbi prindërimin pozitiv, të përshtatura për përdorim nga profesionistët vendorë, përfshirë punonjësit e Njesisë për	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve	2026 2027	Numri i prindërve të këshilluar mbi prindërimin pozitiv, përfshirë ata me aftësi të kufizuar	Bashkia ; donatorë	0	Zv.Kryetari

Mbrojtjen e Fëmijëve , si dhe profesionistët e qendrave komunitare. Trajnimet synojnë fuqizimin e aftësive për mbështetjen e prindërve në funksion të mirëqenies dhe mbrojtjes së fëmijëve.						
A.2.1.3 Zhvillimi i ndërhyrjeve për ndërgjegjësimin e komunitetit shkollor dhe mbështetjen e krijimit të një kulture gjithëpërfshirëse dhe pozitive, që refuzon dhunën, bulizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, në bashkëpunim me institucionet arsimore dhe aktorët lokalë.	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve	2026 2027 2028	Numri dhe % e shkollave ku kanë zbatuar plane të veprimtarive ndërgjegjësuere	Bashkia, donatorë	0	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve
Objekti 2.2: Funksionimi efektiv i një sistemi vendor të mbrojtjes së fëmijëve, gjithëpërfshirës, i koordinuar dhe i dobishëm për identifikimin, referimin dhe ndjekjen e rasteve të riskut.						

A.2.2.1 Ngritja e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve në NJVV në bazë të moduleve të certifikuara dhe aprovuara për menaxhimin e rasteve me qasje ndërsektoriale të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, <i>Partnerë,</i>	2026	% e punonjësve të trajnuar çdo vit; Tematikat e trajnimit	Bashkia, donatorë	0	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve
A.2.2.2 Menaxhimi i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje dhe referimi tek shërbimet	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës	2026 2027 2028	Numri i rasteve të menaxhuara përmes qasjes ndërsektoriale; Numri i rasteve të fëmijëve për të cilët janë marrë masa mbrojtëse; Numri i rasteve të fëmijëve të mbështetur me shërbime; Numri i takimeve ndërsektoriale të zhvilluara; Numri i përfaqësuesve të institucioneve pjesëmarrës në takime;	Bashkia dhe çdo institucion i parashikuar në ligjin për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës	0	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve
Aktiviteti 2.2.3 Shërbimi i këshillimit me	Drejtoria e Shërbimit	2026 2027	Marrëveshje me linjën e Këshillimit	Bashkia në partneritet me	0	Kabineti i Kryetarit

telefon.	Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve	2028	për Fëmijë ALO 116111; Numri i rasteve të fëmijëve që kanë kërkuar dhe kanë marrë këshillim; Numri i rasteve të fëmijëve të referuar tek NJMF përmes linjës së këshillimit;	Linjën e Këshillimit për Fëmijë Alo 116111		
Aktiviteti 2.2.4 Qendër ditore për fëmijë të familjeve me probleme social-ekonomike	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, Stafi i qendrës ditore;	2027 2028	Infrastruktura e godinës e përshtatëshme për ofrimin e shërbimit; Shërbimi i ngritur dhe funksional në përputhje me standartet kombëtare për shërbimin specifik; Stafet profesionale të trainuara për ofrimin e shërbimit; Numri i përfituesve të shërbimit që ofron qendra;	Fondi Social Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia	1'440'000 50'000	Zv.Kryetari
Objektivi 2.3: Parandalim i dhunës në familje, rehabilitim dhe fuqizim për viktimat e dhunës						
A.2.3.1 Ngritja dhe funksionimi i mekanizmit vendor për parandalimin e dhunës në	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe	2026 2027 2028	Marrëveshja e nënshkruar mes Kryetarit të Bashkisë dhe drejtuesve të	Bashkia dhe çdo institucion i parashikuar në legjislacionin	0	Kabineti i Kryetarit

familje dhe adresimin e nevojave të viktimave të saj	Edukimit të Fëmijëve		institucioneve të parashikuara në legjislacionin specifik; Numri i takimeve të Komitetit Drejtues dhe çështjet e diskutuara; Raporte dhe analiza të përgatitura për Komitetin Drejtues; Masa të marra në vijim të takimeve të Komitetit Drejtues; Rritje e ndërgjegjësimit komunitar kundër dhunës; Reduktim i dhunës në familje;	specifik, si dhe organizatat joqeveritare pjesë e Komitetit.		
A.2.3.2 Menaxhimi i rasteve të dhunës në familje dhe referimi tek shërbimet	Koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje në partneritet me administratorët shoqëror	2026 2027 2028	Numri i rasteve të dhunës të referuara; Numri i rasteve të menaxhuara përmes qasjes multisektoriale; Numri i viktimave të dhunës të pajisura me Urdhër mbrojtje/ Urdhër të menjëhershëm mbrojtje; Numri i viktimave të	Bashkia	0	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve

			dhunës që kanë marrë shërbime reabilituese/fuqizues e;			
A.2.3.3 Shërbimi i këshillimit me telefon	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve	2026 2027 2028	Marrëveshje me linjën e Këshillimit për viktimat e dhunës në familje; Numri i rasteve të viktimave të dhunës që kanë kërkuar dhe kanë marrë këshillim; Numri i rasteve të viktimave të dhunës të referuara nga Linja tek koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje;	Bashkia	70'000	Kabineti i Kryetarit
A.2.3.4 Shërbimi i emergjencës 72 orë për viktimat të dhunës në familje	Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Koordinatori vendor për masat kundër dhunës në familje	2026 2027 2028	Apartamentet funksionale për çdo rast; Staf i dedikuar dhe i trainuar për shërbim; Numri i rasteve të akomoduar në kushtet e emergjencës; Numri i rasteve që kanë përfituar	Fondi Social Ministria e Shëndësisë dhe Mbrojtjes Sociale, financim nga donatorët, Bashkia	70'000	Zv.Kryetari

			shërbime reabilituese dhe riintegruese;			
Objekti 2.4: Përmirësimi i cilësisë, efektivitetit dhe përshtatshmërisë së shërbimeve komunitare sociale në nivel vendor, në përputhje me standardet kombëtare dhe nevojat e grupeve në situatë vulnerabilitet.						
A.2.4.1 Zbatimi i një procesi periodik monitorimi nga bashkia për të vlerësuar cilësinë dhe përshtatshmërinë e shërbimeve komunitare sociale që ofrohen në territorin e saj, në përputhje me standardet kombëtare dhe nevojat e përfituesve.	Punonjësi social/ Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve Drejtoria Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror	2026 2027 2028	Numri i monitorimeve të realizuara mbi shërbimet komunitare nga bashkia. Numri i shërbimeve komunitare të vlerësuara për cilësinë dhe përshtatshmërinë. Përqindja e shërbimeve që përmbushin standardet minimale të cilësisë sipas vlerësimit të bashkisë. Numri i rekomandimeve të dalë nga procesi i monitorimit për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Përqindja e rekomandimeve të zbatuara brenda vitit nga ofruesit e	Bashkia	0	Zv.Kryetari

			shërbimeve. Numri i takimeve të organizuara me përfitues ose staf për të mbledhur feedback mbi shërbimet.			
--	--	--	---	--	--	--

20. Monitorimi dhe raportimi

Zbatimi i Planit Vendor Social 2026-2028 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra. Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, participuese dhe të bazuar në të dhëna.

Qasja dhe parimet e monitorimit

Monitorimi do të jetë:

- **i strukturuar**, me përgjegjësi të qarta për çdo njësi zbatuese;
- **i bazuar në tregues të matshëm**, të përcaktuar për çdo aktivitet;
- **i hapur ndaj pjesëmarrjes së komunitetit dhe aktorëve jo publikë**, për të garantuar transparencën dhe përfshirjen.

Njësia e ngarkuar me monitorimin e zbatimit të aktiviteteve:

- **Drejtoria e Shërbimit Social, Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve**, do të luajë rolin koordinues dhe teknik për grumbullimin dhe analizën e të dhënave, do të ndjekë progresin në nivel strategjik dhe do të raportojë në Këshillin Bashkiak.
- **Drejtoritë dhe njësitë zbatuese përkatëse** janë përgjegjëse për dërgimin periodik të informacionit mbi zbatimin e aktiviteteve.

Treguesit e matjes së performancës së shërbimeve të kujdesit shoqëror:

- Për secilin aktivitet në plan janë përcaktuar tregues të qartë si: numri i trajnimeve të realizuara, numri i strukturave të ngritura, ngirtja dhe funksionalizimi i shërbimeve të reja, etj. Treguesit aty ku është e mundur paraqiten të ndarë sipas gjinisë, sipas grupmoshës dhe zonës (urbane/rurale). **Treguesit paraqiten të detajuar në planin e veprimit, për secilin aktivitet.**

Formatet e raportimit

Raportimi do të realizohet:

- **Çdo 6 muaj**, përmes një formati të thjeshtuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës së realizimit të planit social, që do të përdoret nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative.

- **Çdo vit**, përmes një raporti të përmbledhur vjetor mbi progresin e Planit, i cili do të publikohet në faqen e internetit të bashkisë dhe do t'u prezantohet këshilltarëve dhe komunitetit.
- Raporti vjetor do të përmbajë analiza të të dhënave, shembuj praktikë nga territori, si dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

Mbledhja e të dhënave, analiza dhe dixhitalizimi

Brenda vitit të parë të zbatimit, do të krijohet një regjistër dixhital për monitorimin dhe publikimin e statistikave dhe progresit të planit. Ky informacion do të jetë e hapur për publikun, duke mundësuar qasje transparente në të dhëna dhe nisma.

Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar

Në fund të vitit 2027 do të realizohet një vlerësim ndërmjetës, për të analizuar ritmin e zbatimit dhe për të bërë rregullime në plan, nëse është e nevojshme. Në vitin 2028, do të përgatitet raporti përfundimtar i zbatimit, që do të shërbejë si bazë për hartimin e planit të ardhshëm.

21. Bibliografi

Asambleja e Kombeve të Bashkuara. (1948). *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*.

Kuvendi i Shqipërisë. (2016). *Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”*. Fletorja Zyrtare nr. 193, datë 14.11.2016.

Kuvendi i Shqipërisë. (2014). *Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*. Fletorja Zyrtare nr. 215, datë 17.12.2015.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2020). *Standardet minimale për shërbimet sociale në komunitet për persona në nevojë*. Tiranë.

Këshilli i Ministrave. (2018). *VKM nr. 505, datë 13.09.2018 “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve sociale”*. Fletorja Zyrtare.

Këshilli i Ministrave. (2018). *VKM nr. 118, datë 13.3.2018 “Për procedurat e licencimit dhe akreditimit të ofruesve të shërbimeve sociale”*.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. (2022). *Manuali për monitorimin e standardeve të shërbimeve për fëmijë*.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2021). *Udhëzues për menaxhimin e rasteve në shërbimet sociale komunitare*.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). (2022). *Raporti për kapacitetet e njësive të vetëqeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve sociale*.

Save the Children Albania & UNICEF Albania. (2021). *Manual praktik për bashkitë për zhvillimin e shërbimeve sociale*.

Lista e legjislacionit të marrë në analizë

Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar; (në veçanti Nenet 49, 51, 52, 55);

- Ligj nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (OKB)”;
- Ligji nr.7767, datë 9.11.1993 “Për aderimin në Konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”;
- Ligji nr. 104/2012, datë 8.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”;
- Ligji nr. 108 , datë 2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB -së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”;

- Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut” dhe Protokolli nr. 7 i KEDNj;
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji nr. 8774, datë 23.4.2001 “Për ratifikimin e Konventës nr.182 “Format më të këqija të punës së fëmijëve, 1999” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”;
- Ligj nr. 9359, datë 24.3.2005 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane “Për marrëdhëniet me fëmijët”;
- Ligji nr. 10 071, datë 9.2.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”;
- Ligji nr. 10 425, datë 2/6/2011 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve;
- **Ligji nr. 121, datë 24.11.2016, ”Mbi Shërbimet e Kujdeist Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;**
- Ligji nr. 163/2014 “Për urdhërin e punonjësve social në Republikën e Shqipërisë “;
- Ligji nr. 40/2016, i ndryshuar “Për urdhërin e psikologut në Republikën e Shqipërisë»;
- **Ligji 18/2017 ”Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;**
- **Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;**
- Ligji nr. 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar ;
- **Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;**
- Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”;
- Ligj nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 65/2016 datë 9.6.2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Karta Evropiane për Autonomi Lokale;
- VKM nr 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” (ndryshuar me vendimin nr. 85, datë 10.2.2021;nr. 868, datë 29.12.2021; nr. 617, datë 22.9.2022);

- VKM nr. 182, datë 26.2.2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal” i ndryshuar;
- VKM nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre” i ndryshuar;
- VKM nr.31, datë 20.1.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar;
- VKM nr.78, datë 7.2.2007 “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, i ndryshuar;
- VKM nr.869, datë 18.6.2008 “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “statusi i invalidit”, i ndryshuar;
- VKM nr.277 date 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”;
- Vendim nr. 257, datë 5.5.2021 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale”;
- Vendim nr. 135, datë 7.3.2018 “Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror”, i ndryshuar;
- Vendim nr. 617, datë 20.10.2021 “Për treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre”;
- Vendim nr. 751, datë 1.12.2022 “Për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç”;
- Vendim nr. 56, datë 31.1.2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”;
- Vendim nr. 174, datë 24.3.2023 “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2023–2025”;
- VKM Nr. 768 datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të vecanta”;
- VKM 518/2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”;

- **VKM Nr. 149, datë 13.3.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”;**
- VKM 136/2018 “Për funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror”;
- VKM Nr. 135, datë 7.3.2018 “Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror”;
- VKM Nr. 848, datë 28.10.2020 “Për standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të ofruesve të tyre”;
- **VKM Nr. 624, datë 29.07.2020 “Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror”;**
- VKM nr. 111 datë 23 shkurt 2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social;
- VKM Nr. 150 datë 20/03/2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.